3. Organizimi: përdor të gjitha burimet e mundshme dhe fondet, përfshirë stafin dhe ekspertizën e jashtme, sic lejohet, për të aritur qëllimet e institutit. Përgatit dokumentacionin e duhur për takimet e bordit dhe takimet e komisionit dhe mundëson shërbime sekretariale për komisionet e ndryshme, nëse është e nevojshme: rishikon dhe azhuron të gjitha procedurat e brendshme në fushë dhe siguron përputhjen me sigurinë e sistemit dhe kërkesave funksionale; studion dhe përgatit strukturën e duhur të bazës së të dhënave, rrjedhën e të dhënave të planifikuara për azhurnimin e bazës së të dhënave dhe siguron mbikqyrjen për mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemit.
4. Koordinimi: koordinon aktivitetin e njërive në vartësi; sinkronizon planet dhe veprimtaritë e drejtorive dhe sektorëve të ISSH dhe të institucioneve të tjera jashtë ISSH në lidhje me çështjet e IT.
5. Kontrolli: siguron që sistemet e kontrollit të brendshëm janë të dokumentuara dhe të zbatuara dhe vlerësimi i performancës është bërë në të gjithë organizatën, propozon tek Drejtori i Përgjithshëm njoftime dhe jep argumente për masat disiplinore të marra ndaj nëpunësve përgjegjës për problemet e identifikuara; aplikon sanksione në rast të mos respektimit të rregullave të brendshme organizative në përputhje me Rregulloren e Brëndshme. Mbikqyr implementimin e akteve ligjore dhe proceduriale në fushën e tij të aktivitetit në secilin rajon dhe respektimin e afateve për implementimin e detyrave, propozon përmirësimet që duhen bërë, vlerëson masat që propozohen për t'u ndërmarrë. Për këtë, organizon kontrole tematike në rajone dhe agjensitë që kanë problem. Analizon rezultatet e raporteve mujore të kontrollorëve dhe përpunon raportet mbi gabimet lidhur me aspektet e IT. Bashkëpunon dhe përgjigjet për të gjitha kërkesat e drejtorisë së Auditit për të siguruar aksesin në të gjithë informacionin e nevojshëm në përputhje me legjislacionin lidhur me pikat e mëposhtme: procedurat, sistemet e sigurisë, nivele të ndryshme aksesi ekzistuese në organizatë.

Arsimi dhe Eksperienca:

Diplome universitare në IT, Inxhinieri dhe ose të paktën 10 vjet eksperiencë në fushën e administrimit publik dhe ose nivel të lartë menaxhimi; në rast diplome "master" të paktën 7 vjet ekspseriencë në fushën e administrimit publik dhe ose nivel të lartë menaxhimi. Ekspseriencë në bashkëpunimin me institutet publike dhe private është e detyrueshme. Eksperienca në manaxhimin e sistemeve të informacionit.

Aftësitë:

1. Aftësi të mira organizative dhe aftësi për të identifikuar dhe përdorur burimet financiare dhe njerëzore për të arritur objektivat.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

2. Aftësi të mira dhe aftësi për t'u marrë me stafin e të gjitha niveleve të organizatës.
3. Aftësi të mira në vendimarrje dhe aftësi për të shpjeguar dhe mbështetur vendimet.
4. Aftësi të mira drejtuese dhe aftësi për të vendor kulturën e punës në organizatë dhe të formojë qëndrimet kyce të stafit të ISSH
5. Standarte të larta personale të sjelljes dhe vlerave, një shëmbull për t'u ndjekur nga stafi.

Përgjegjësi i Sektorit – Zhvillimi i Programit

Detyra të Përgjithshme: Të mbështesë Drejtorin e Drejtorisë për të mbajtur një zhvillim efektiv dhe eficient të njësisë së zhvillimit të programit në Zyrën Qëndrore.

Përgjegjësitë:

1. Koordinimi Hierarkik: Lidhet me Drejtorin e Drejtorisë së IT për planifikim, zhvillim dhe implementim të iniciativave të ISSH në zonat e përgjegjësisë së IT: zhvillimin e programit dhe të administrimit të bazës së të dhënave. Raporton tek Drejtori i Drejtorisë, mbikqyrësit e tjerë hierarkikë dhe Drejtori i Përgjithshëm mbi problemet kyce të sektorit së tij: nivelet dhe tendencat në produktivitetin në punë, standartet e cilësisë, plotësimi me staf, volumet e punës, puna e bërë dhe buxhetet.
2. Mundëson ekspertizë të specializuar dhe mbështetje për zhvillimin e programit, administrimin e bazës së të dhënave.
3. Koordinimin: bashkëpunim me stafin e DRSSH për arritjen e rezultateve.

Prezantimi i Detyrave

1. Zhvillimi i programit: mbikqyr zhvillimin e aplikimeve të reja dhe amendimeve ndaj programeve ekzistuese. Lidhet me drejtoritë e ISSH në të gjitha nivelet e administrimit për të caktuar kërkesat e punës. Zhvillon propozime për mjediset e zhvillimit të programit.
2. Administrimi i bazës së të dhënave: planifikimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i bazës së të dhënave sipas parimet në vijim: të dhënat mbeten konsistente përgjatë bazës së të dhënave; të dhënat qartësohen mirë, përdoruesit hyjnë tek të dhënat në një formë që duket e përshtatshme për nevojat e tyre; mundësohet siguria e të dhënave dhe kontrolli i rivendosjes në (të gjitha të dhënat mund të tërhiqen në rast urgjence); duke vendosur nevojat e përdoruesve; planifikimin e rrjedhës së të dhënave për një bazë të dhënash të re ose të rishikuar; hartimi i “projektit konceptual” për një bazë të dhënash të planifikuar; duke konsideruar si “Back end (kufiri fundit)” ashtu dhe “Front end (kufiri i fillimit)” për të gjithë përdoruesit; duke përcaktuar “projektin logjik” që të mund të përkthehet në model datash specifike; rregullime të mëtejshme të “projektit fizik” për të arritur kërkesat e magazinimit të sistemit’ testimin e sistemeve të reja; mirëmbajtjen e standarteve të të dhënave, përfshirë aderencën me aktet e mbrojtjes së të dhënave, shkrimi i dokumentacionit të bazës së të dhënave, përfshirë standartet e të dhënave, procedurave dhe përkufizimet për fjalorin e të dhënave (metadata); kontrollin e lejimit të aksesit dhe të privilegjeve; trajnimi i përdoruesve; arritja e kërkesave të hyrjes së përdoruesve dhe zgjidhja e problemeve të tyre; sigurimi që magazinimi, arkivimi, back up dhe procedurat e rikthimit (rigjenerimit) po funksionojnë korrekt; Planifikimi i kapaciteteve; të bashkëpunojë me menaxherët e projektit të IT, programuesit të bazës së të dhënave dhe

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

zhvilluesve të rrjetit; mundësimi i mbështetjes teknike për sistemet e programeve të dala kohe që ekzistojnë në organizatë.

3. Koordinimi: bashkëpunim me stafin e ISSH dhe DRSSH për arritjen e rezultateve. Lidhet me klientët e brendshëm të të gjitha niveleve për të zgjidhur problemet lidhur me IT dhe mundëson përgjigje brenda afateve.

Arsimi dhe Eksperienca

Diplomë universitare në IT, Inxhinieri dhe të paktën 5 vjet eksperiencë në fushën e zhvillimit të programeve/analist sistemesh në një post menaxhuesi.

Aftësitë:

1. Aftësi të mira ndërpersonale. Këto përfshijnë aftësi dëgjimi, zgjidhje konfliktesh, komunikimit në grup dhe aftësi për t'u marrë efektivisht me menaxherët.
2. Të ndihmojë të vendosen dhe mirëmbahen sistemet e duhura të vlerave në fushën e zhvillimit.
3. Të monitorojë, vlerësojë dhe raportojë mbi çështjet në sektorin e Zhvillimit, planeve dhe performancës në punë.

Specialisti – Analist/Programues

Detyra të përgjithshme: të mbështesë Përgjegjësën e Sektorit – Zhvillimin e Programit për zhvillimin e programit dhe azhornimin.

Përgjegjësitë:

1. Lidhet me Kreun e Njesisë për hartimin e kërkesave të nevojshme funksionale
2. Lidhet me të gjitha nivelet e administrimit për të përcaktuar kriteret e punës për zhvillimin dhe azhornimin e programit.
3. Analizon kërkesat dhe projektimin e sistemit përfshirë të gjitha veprimtaritë lidhur me administrimin e bazës së të dhënave.
4. Zhvillon, teston dhe dokumenton aplikimet e reja apo amendimet për aplikimet ekzistuese.

Prezantimi i Detyrave

1. Analiza, projektim (i aplikimit të programit dhe bazës së të dhënave), zhvillimin dhe dokumentacionin e programeve

Arsimi dhe Eksperienca

Diplomë universitare në IT, Inxhinieri dhe të paktën 2 vjet eksperiencë në fushën e zhvillimit të programeve/analist sistemesh në një post menaxhuesi.

Aftësitë:

1. Aftësi të mira ndërpersonale. Këto përfshijnë aftësi dëgjimi, zgjidhje konfliktesh, komunikimit në grup dhe aftësi për t'u marrë efektivisht me menaxherët.
2. Të ndihmojë të vendosen dhe të mirëmbahen sistemet e duhura të vlerave në fushën e zhvillimit.

Sektori i Administrimit të Rrjetit Përgjegjës i Sektorit

Detyra të përgjithshme: Mbështet drejtorin duke mbajtur një rrjet efektiv dhe eficient në ISSH dhe në DRSSH.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

Përgjegjësitë:

1. Koordinimi Hierarkik: Lidhet me Drejtorin e Drejtorisë së IT për planifikim, zhvillim dhe implementim të iniciativave të ISSH në zonat e përgjegjësisë së IT: zhvillimin e rimëkëmbjes nga dëmtimi dhe planet për vazhdimësinë e punës. Raporton tek Drejtori i Drejtorisë, mbikqyrësit e tjerë hierarkik dhe Drejtori i Përgjithshëm mbi problemet kyce të njësisë së tij: nivelet dhe tendencat e produktivitetit të punës, standarteve të cilësisë, plotësimi me stafin e duhur, volumnet e punës, puna e bërë dhe buxhetet. Shërben si pika e kontaktit për veprimet e IT
2. Mundëson ekspertizë të specializuar dhe mbështetje për politikat e sigurisë së sistemit, standartet dhe udhëzimet.
3. Koordinimin: bashkëpunim me stafin e DRSSH dhe të ALSSH për arritjen e rezultateve. Lidhet me të gjithë klientet e brendshëm në të gjitha nivelet për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve lidhur me IT dhe mundëson përgjigjet brenda afateve kohore.

Prezantimi i detyrave

1. Menaxhon zhvillimin dhe implementimin e politikave globale të sigurisë, standartet, udhëzimet dhe procedurat për të siguruar mirëmbajtjen e sigurisë së vazhdueshme.
2. Të identifikojë qëllimet mbrojtëse, objektivat dhe metrikat lidhur me planin e përbashkët strategjik.
3. Të sigurojë mbrojtjen e informacionit, përgjegjësitë përfshijnë arkitekturën e sigurisë së rrjetit, hyrjen në rrjet dhe politikat e monitorimit, trainimin e nëpunësve dhe përkujdesjen.
4. Të kujdeset për planifikimin e përgjigjes ndaj incidenteve si dhe investigimin e shkeljeve të sigurisë dhe të asistojë me çështjet disiplinore dhe ligjore lidhur me shkelje të tilla, kur është e nevojshme.
5. Dokumenton procedurat e instalimit dhe manualet e ndihmës në rast problemesh
6. Punon me auditin e brendshëm dhe mundëson të gjitha informacionet si dhe me këshilltarët e jashtëm për auditime të pavarura për sigurinë në përputhje me legjislacionin.

Arsimi dhe Eksperienca

Diplomë universitare në IT, Inxhinieri dhe të paktën 5 vjet eksperiencë në fushën e Menaxhimit të Operacioneve

Aftësitë:

1. Aftësi të mira ndërpersonale. Këto përfshijnë aftësi dëgjimi, zgjidhje konfliktesh, komunikimit në grup dhe aftësi për t'u marrë efektivisht me menaxherët.
2. Të ndihmojë të vendosen dhe mirëmbahen sistemet e duhura të vlerave në fushën e veprimeve të IT.
3. Të monitorojë, vlerësojë dhe raportojë mbi çështjet në sektorin e veprimeve të IT, planeve dhe performancës në punë.

Specialisti – Administratori i Rrjetit (Pajisjet/Rrjeti)

Detyra të përgjithshme: Të mbështesë Përgjegjësin e Sektorit të veprimeve të IT në krijimin, konfigurimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e politikave të sigurisë së sistemit në zyra

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

1. Lidhet me Përgjegjësin e Veprimeve me IT në zhvillimin dhe implementimin e iniciativave të ISSH.
2. Vendos dhe konfigurion Rrjetet e Lokale (LAN), Rrjeti ËAN , Serverat, Kompjuterat, Magazinimi Masiv, Njësitë me shirita dhe Periferik të tjerë.
3. Administrimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës në zyrë.
4. Administrimi dhe mirëmbajtja e aplikacioneve të ISSH
5. Trajnimi i klientëve të brendshëm për të përdorur pajset
6. Lidhet me klientët e brendshëm në të gjitha nivelet për të zgjidhur problemet lidhur me IT.

Prezantimi i Detyrave

1. Formimi, konfigurimi, administrimi dhe mirëmbajtja e politikave të sigurisë së sistemit dhe infrastruktura e zyrës së caktuar.

Arsimimi dhe Eksperienca

Diplomë universitare në IT, Inxhinieri dhe/ose të paktën 2 vjet eksperiencë në fushën e Administrimit të Sistemeve.

Aftësitë:

1. Aftësi të mira ndërpersonale. Këto përfshijnë aftësi dëgjimi, zgjidhje konfliktesh, komunikimit në grup dhe aftësi për t'u marrë efektivisht me menaxherët.
2. Të ndihmojë të vendosen dhe mirëmbahen sistemet e duhura të vlerave në fushën e veprimeve të IT.
3. Të monitorojë, vlerësojë dhe raportojë mbi çështjet në sektorin e veprimeve të IT, planeve dhe performancës në punë.

Sektori i Administrimit të Bazës së të Dhënave

Specialist – Administratori i Sistemeve

Detyra të përgjithshme: të mbështesë Përgjegjësinë Sektorit të veprimeve të IT në krijimin, konfigurimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e aplikacioneve të programit dhe bazës së të dhënave.

Përgjegjësitë

1. Lidhet me Përgjegjësin e Sektorit të IT – Veprimeve të IT në zhvillimin dhe implementimin e iniciativave të ISSH.
2. Krijon dhe konfiguron aplikacionet e ISSH (përfshirë internetin dhe intranetin)
3. Procedurat e instalimit të dokumentacionit dhe manualëve për zgjidhjen e problemeve.
4. Administrimin dhe mirëmbajtjen e aplikacioneve të ISSH
5. Krijon dhe monitoron siguresit e bazës së të dhënave (rimëkëmbja, integriteti i të dhënave, siguria, mundësia dh performance, menaxhimi i storage-it (vendruajtje)
6. Ndërvepron me klientët e brendshëm në të gjitha nivelet për të zgjidhur problemet lidhur me IT.

Prezantimi i Detyrave

1. Krjon, konfiguron, administron dhe mirëmban aplikacionet dhe bazën e të dhënave.

Arsimi dhe Eksperienca

Diplomë universitare në IT, Inxhinieri dhe/ose të paktën 2 vjet eksperiencë në fushën e Administrimit të Bazës së të dhënave dhe të Aplikacioneve.

Aftësitë:

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

1. Aftësi të mira ndërpersonale. Këto përfshijnë aftësi dëgjimi, zgjidhje konfliktesh, komunikimit në grup dhe aftësi për t'u marrë efektivisht me menaxherët.
2. Të ndihmojë të vendosen dhe mirëmbahen sistemet e duhura të vlerave në fushën e IT.
3. Të monitorojë, vlerësojë dhe raportojë mbi çështjet në sektorin e IT.

Sektori për Regjistrimin – (I perkohshem – deri ne momentin e venies ne pune te Sistemit)

Periudha tranzitore në procesin automatik (SIMIS në organizim dhe implementim) bën të nevojshme për një sektor të regjistrimit në nivel qendror për gjenerimin e NSSH unike. Dhënie e kërkesës për NSSH do të bëhet në nivle local; të gjitha kërkesat centralizohen në nivle rajonal dhe transferohen në Zyrën qendrore për të gjeneruar numrin.

- *Kjo do të jetë e lidhur me SIMIS – DRSSH tiranë dhe do të punojë me këtë bazë të dhënash për të gjeneruar NSSH.*
- *Ky sektor do të mundet edhe të marrë të gjitha listëpagesat e skanuara dhe të indeksuara në CD nga të gjitha DRSSH, sipas procedurave të reja të skanimit dhe do të hedhë imazhet në arkivën elektronike të SIMIS – shikoni përshkrimin e punës së operatorit*

Pergjegjes i Sektorit

Detyra të përgjithshme:

1. Përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e veprimtarive lidhur me regjistrimin e kontribuesve me NSSH.
2. të raportojë rregullisht mbi rastet në vazhdim dhe të zgjidhura të regjistrimit;
3. të mundësojë tek Departamenti I Auditit – Njësia e Raproteve dhe tek Drejtori I Përgjithshëm me raportet mbi dallimet mes kontribuesve të regjistruar për secilën kategori dhe statistikave e mundësuar nga INSTAT për secilën kategori potenciale të kontribuesve të sistemit të sigurimeve shoqërore.
4. Të mbështesë njësinë e punëmarrësve duke mundësuar ekspertizë të specializuar në të gjitha aspektet lidhur me procesin e regjistrimit: procedurat, formatet zyrtare (formularin e kërkesit dhe formularin e njoftimit) draftimin e legjislacionit të nevojshëm për implementimin e proceseve.

Përgjegjësitë:

1. koordinimi hirarkik: lidhet me Drejtorin e Përgjithshëm në monitorimin e procesit të regjistrimit; raporton tek Drejtori, dhe mbikqyrësit e tjetër hirarkik mbi çështjet kyce të Njesisë
2. Mundëson ekspertizë të specializuar dhe mbështetje për të arritur në vonesat ligjore të gjitha procedurat e regjistrimit dhe të zgjidhë të gjitha rastet; të drejtojë dhe mbështesë me këshilla të specializuara stafin nën vartësi për arritjen e detyrave
3. Koordinimi: të bashkëpunojë me Departamentin e Kontributeve për të azhurnuar formularët dhe procedurat për regjistrim në përputhje me ndryshimet legjislative. Të ekzaminojë korrespondencën dhe aktet e tjera që adresohen tek Njësia, merr masa dhe jep detyrat tek punojësit për të zgjidhur problemet në kohë.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

Detyrat:

1. Koordinon procesin e përpunimit të rregulloreve lidhur me regjistrimin e kontribuesve me NSSH
2. Përgatit raprote të rregullta lidhur me procesin e regjistrimit.
3. bashkëpunon me të gjitha Departamentet brënda ISSH dhe autoriteteve publike qendrore për hartimin e legjislacionit dhe implementimin në fushë.
4. Të mundësojë asistencë të specializuar për të gjithë punojësit e ISSH përfshirë në proces dhe vlerëson raportet e kontrollorëve lidhur me problemet e hasura në DRSSH gjatë procesit të regjistrimit përfshirë marrëdhëniet me aplikuesit.

Arsimimi dhe eksperiencia:

Diplomë universitare në matematikë, ekonomi, juridik apo administratë publike dhe studime të tjera lidhur me to dhe të paktën 5 vjet punë në fushën e administratës publike dhe në nivel të lartë manaxherial; në rast të një masteri të paktën 3 vjet punë në fushën e administrimit publik ose në nivel të lartë manaxherial. Eksperiencë në bashkëpunim me institutet private dhe publike është e detyrueshme.

Aftësitë:

1. Aftësi të mira organizative dhe aftësi për të identifikuar dhe të përdore burimet financiare dhe njerëzore për të arritur objektivat
2. Aftësi të mira ndërpersonale dhe aftësinë për t'u marrë me stafin e të gjitha niveleve të institucionit
3. Aftësi të mira vendimarrje dhe aftësi për të shpjeguar dhe mbështetur vendimet
4. aftësi të forta drejtimi dhe aftësi për të vendosur kulturën e punës të organizatës dhe për të formuar sjelljet kyce të stafit të ISSH
5. Standarte të larta personale të sjelljes dhe vlerave, një shëmbull për t'u ndjekur nga stafi
6. Njohuri të mira të legjislacionit në këtë fushë është e detyrueshme

SPECIALISTI NË KOORDINIMIN METODOLOGJIK TË PROCESIT TË REGJISTRIMIT

Specialist ne sektorin e regjistrimit qendror dhe NSSH

Prezantimi i Detyrave:

1. Ndjek implementimin e procedurave për regjistrim në të gjitha rastet dhe mundëson koordinimin metodologjik: a) vendos udhëzimet për t'u ndjekur për të patur një proces të saktë të regjistrimit; siguron se proceset automatike janë korrekte për të gjeneruar NSSH dhe për të shmangur duplikimet në sistem; siguron se numrat e kontratave nuk janë të duplikuar në nivel kombëtar; siguron nëse procedurat e njoftimit janë aplikuar dhe nëse cdo kontribues është pajisur me me NSSH apo me një numër kontrate dhe a janë njoftuar ata për këtë gjë.
2. Ndjek performancën e stafit në lidhje me: marrjen e ankesave, përpunimin dhe zgjidhja e ankesës, dorëzimi i njoftimeve; performanca në punë, implementimi i afateve kohore të krijuar për procesin e regjistrimit.
3. Përgatit udhëzimet metodologjike për azhurnimin sa herë është e nevojshme për bazën e të dhënave të kontribuesve; përcakton kriteret për azhurnim; organizon procesin dhe komunikon me kontribuesit.
4. monitoron cilësinë e të dhënave të hedhura në sistem.
5. kontrollon realizimin e kuotave për operatorët – nëse procesi vazhdon të bëhet manualisht.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

6. përgatit statistikat e nevojshme dhe i raporton tek Drejtori i Përgjithshëm mbi ratën mes numrit të kontribuesve dhe atyre të regjistruar.
7. Manaxhon dokumentat justifikues në letër apo në mënyrë elektronike dhe i dorëzon ato për t'u arkivuar: vendos kriteret për indeksimin dhe klasifikimin.
8. Bën propozime për ndryshimet apo ndërhyrjet në sistemin e informatikës
9. Mundëson përgjigje brënda afateve kohore për të gjitha kërkesat e korrespondencës apo ankesave të marra nga qytetarët, kompanitë; organizon shpërndarjen e tyre tek punojësit; jep këshilla për gjetjen e zgjidhjeve.
10. organizon dhe manaxhon punën për trajnimin dhe kualifikimin e inspektorëve përmes sesioneve gjeneralizuese, seminareve, sesioneve konsultative dhe forma të tjera.

Arsimimi dhe Eksperienca

Diplomë universitare në matematikë, informatik, juridik, shkenca sociale dhe të paktën 5 vjet punë në fushën e administrimit publik; në rast të një diplome master të paktën 3 vjet punë në fushën e administrimit publik. Është e detyrueshme eksperienca në bashkëpunim me autoritetet publike dhe private.

Aftësitë

1. Aftësi të mira organizative dhe aftësi për të identifikuar dhe të përdore burimet financiare dhe njerëzore për të arritur objektivat
2. Aftësi të mira ndërpersonale dhe aftësinë për t'u marrë me stafin e të gjitha niveleve të institucionit
3. Aftësi të mira vendimarrje dhe aftësi për të shpjeguar dhe mbështetur vendimet
4. aftësi të forta drejtimi dhe aftësi për të vendosur kulturën e punës të organizatës dhe për të formuar sjelljet kyce të stafit të ISSH
5. Standarte të larta personale të sjelljes dhe vlerave, një shëmbull për t'u ndjekur nga stafi
6. Aftësi kompjuterike dhe gjuhë të huaj
7. njohuri të mira të procedurave ligjore dhe kriterëve për procesin e regjistrimit
8. njohuri të mira të sistemit të sigurimeve shoqërore në Shqipëri.

Operatori për gjenerimin e Numrit të Sigurimeve Shoqërore – post i përkohshëm pune aq sa të zgjasë procesi manual që është në implementim

Detyra të përgjithshme: të japë NSSH, bazuar në kërkesat e ALSSH; të azhurnojë historikun e punës për cdo kontribues me CD e mara nga DRSSH që nuk janë të lidhura me SIMIS; të hedhë të dhënat për projektet e ndryshme të zhvilluara nga ISSH.

Përgjegjësitë:

1. Lidhet me Kreun e Njesisë për të gjitha veprimtaritë
2. e njesisë lidhur me procesin e regjistrimit dhe azhurnimin e historikut të punës.
3. ndërlidhet me të gjitha departamentet e ISSH të të gjitha niveleve për të arritur qëllimet dhe planet e njesisë
4. mundëson mbështetje të plotë për planifikimin dhe organizimin e veprimtarive dhe për të dhënë NSSH.

Detyrat

1. merr kërkesën për NSSH nga ALSSH
2. verifikon saktësinë e kërkesës dhe jep NSSH. Kontrollon me të dhëna shtesë identifikimi për të shmangur duplikimet (atësia, data dhe vëndi i lindjes)

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

3. jep njoftimin për NSSH dhe e dërgon atë tek DRSSH, Departamenti i Kontributeve (vetëm për rastet manuale) Për sa i përket SIMIS, njoftimet jepen në nivel lokal
4. merr dhe sqaron ankesat e kontribuesve mbi dhënien e NSSH.
5. Merr nga DRSSH CD me imazhet e skanuara të listëpagesave dhe i hedh ato në Arkivën Elektronike të SIMIS, duke aplikuar procedurat e indeksimit për cdo njësi. Shënon CD nëse ato nuk janë shënuar në DRSSH dhe i dërgon ato tek Departamenti i Arkivës për klasifikim dhe arkivim në Arkivën e Centralizuar.
6. Merr pjesë në veprimtaritë për të vendosur dhe azhurnuar kërkesat funksionale për SIMIS në përputhje me ndryshmet në legjislacion, në procedura dhe në rrjedhën e punës.

Arsimi dhe Eksperienca

Diplomë universitare në ekonomi, matematik, informatik etj dhe të paktën 2 vjet punë është e detyrueshme. Eksperienca në punën me bazën e të dhënave është avantazh.

Aftësitë:

1. Aftësi të mira ndërpersonale. Kjo përfshin aftësi të mira dëgjimi, zgjidhje konfliktesh, komunikimi në grup dhe aftësia për t'u marrë efektivisht me manaxherët.
2. Aftësi kompjuterike
3. aftësi në hedhjen e të dhënave, mbajtja e kontaktit me Inspektorët ose aplikuesit për përgjigjen në kohën e duhur.

Operatorët të tjerë: nëse do të duheshin operatorë të tjerë të përkohshëm për hedhjen e të dhënave në ISSH do të aplikohen të njëjtat përshkrime pune duke marrë në konsideratë diferencat në rrjedhën e punës dhe në procedura.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

ORGANIZIMI I KABINETIT:

Shef i Kabinetit

Sekretar

Asistent

Keshilltare per ceshtje te ndryshme

PERSHKRIMI I PUNES:

Shef i Kabinetit

Detyra e pergjithshme:

1. pergjigjet per koordinimin e te gjitha sherbimeve brenda Kabinetit
2. mbeshtet DP per mire-menaxhimin e institucionit

Pergjegjesite:

1. siguron mbeshtetje per organizimin dhe mire-funksionimin e punes brenda njesive ne varesi te DP
2. koordinimi: bashkepunon me te gjitha sherbimet e Kabinetit per shperndarjen e informacionit perkates qe nevojitet per arritjen e rezultateve.

Detyrat:

1. vendos se bashku me DP axhenden javore
2. organizon te gjitha takimet e DP dhe kerkon nga drejtoret e ISSH te pergatisin dokumentat perkatese
3. koordinon punen e sherbimeve dhe cakton takimet e perhershme te punes per marrjen e vendimeve ne kohe
4. merr pjese apo perfaqeson DP ne takime te ndryshme kur kjo i kekohet.

Arsimi dhe eksperienca:

Ky pozicion pune nuk kerkon kompetenca specifike dhe eshte zgjedhje individuale e DP qe behet ne perputhje me nevojat specifike per organizimin e kabinetit te vet. Rekomandohet te kete njohurite e duhura per legjislacionin dhe procedurat e sigurimeve shoqerore apo per menaxhimin e institucioneve publike dhe komunikimin institucional.

Aftesite:

1. aftesi per te perballuar me sukses situatat dhe per te kontrolluar situatat konfliktuale
2. nivele te larta te integritetit
3. te komunikojte efektivisht me stafin e ISSH

Asistent

Detyra e Pergjithshme: te siguroje mire-funksionimin e punes brenda Kabinetit dhe sekretar i Keshillit Administrativ te ISSH

Pergjegjesite:

1. bashkevepron me DP per te realizuar planifikimin e mbledhjeve dhe te aktiviteteve te Kabinetit si dhe te Keshillit Administrativ te ISSH
2. jep mbeshtetje te plote per planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve

Detyrat:

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

1. pergatit protokollin e mbledhjeve kur kjo i kerkohet nga DP
2. menaxhon axhenden javore sic vendoset nga DP

Per Keshillin Administrativ:

3. njofton anetaret e Keshillit Administrativ per daten, kohen dhe vendin e mbledhjes
4. pergatit se bashku me Kryetarin axhenden dhe ua dergon ate pjesemarresve
5. merr masa per pergatitjen e dosjeve me dokumenta per mbledhjet dhe ua jep ato anetareve te Keshillit Administrativ
6. pergatit protokollet e mbledhjeve, ua shperndan protokollet te gjithe pjesemarresve, merr reagimin dhe reflektimin (feedback-un) e pjesemarresve dhe integron komentet per to
7. merr masat per arkivimin e materialeve dhe te vendimeve te marra ne cdo mbledhje te Keshillit Administrativ.

Arsimi dhe Eksperienca:

Diplomim universitar ne jurisprudence, shkenca shoqerore, administrim publik, ekonomik dhe eshte e detyrueshme te pakten 2 vjet eksperience pune. Rekomandohet te kete eksperience ne bashkepunimin me institucionet publike.

Aftesite:

1. Duhet te kete aftesi te shendosha nderpersonale. Ne to perfshihen: aftesi te mira per te degjuar te tjeret, per zgjidhjen e mosmarreveshjeve, komunikim ne grup dhe zotesi per bashkepunim efektiv me menaxheret
2. Njohje te mire te legjislacionit te fushes.

Sekretar

Detyra e pergjithshme:

Te siguroje sherbimet e sekretarise

Pergjegjesite:

1. regjistron dhe menaxhon korrespondencen e marre dhe te derguar nga Kabineti.
2. regjistron dhe menaxhon dokumentat qe hyjne dhe dalin nga Kabineti
3. jep pergjigje thirrjeve telefonike, emaileve.
4. pergatit mbledhjet brenda dhe jashte ISSH dhe organizon udhetime te punes
5. arkivon dokumentat.

Arsimi dhe eksperienca:

Diplomim universitar ne juridik, shkenca sociale, administrim publik, ekonomik. Rekomandohet eksperience ne bashkepunimin me institucionet publike.

Aftesite:

1. aftesi te mira nderpersonale; ne keto perfshihen: aftesi per te degjuar te tjeret, per zgjidhje te mosmarreveshjeve, komunikim ne grup dhe aftesi per te punuar ne menyre efektive me menaxheret.
2. njohuri te mira te legjislacionit te fushes.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

ORGANIZIMI I SEKTORIT TË MARRËDHËNIEVE DHE KOMUNIKIMIT ME PUBLIKUN

Pergjegjes Sektori

Specialist per marrëdhëniet me publikun dhe komunikimin

Pergjegjes i Sektorit

Detyra të përgjithshme:

1. Përgjegjës për menaxhimin e veprimtarive të sektorit lidhur me organizimin e procedurave të komunikimit të jashtëm dhe të brendshëm.
2. Përgjegjës për promovimin e imazhit të institutit përmes kanaleve të ndryshëm të komunikimit me median për të mbajtur një perceptim të mirë publik të të interesuarve për arritjet e organizatës dhe axhendën.
3. Të mbështesë Bordin e Drejtorëve dhe Drejtorin e Përgjithshëm të ISSH duke mundësuar ekspertizë të specializuar për rritjen e besimit të publikut në sistemin e sigurimeve shoqërore.

Përgjegjësitë:

1. Koordinimi hierarkik: lidhet me Bordin e Drejtorëve të ISSH dhe Drejtorin e Përgjithshëm për promovimin e nje imazhi të besueshëm institucional: raporton tek Shefi i Kabinetit, mbikqyrësit e tjerë të hierarkisë dhe Drejtori i Përgjithshëm mbi çështjet kyce të Sektorit.
2. Mundëson ekspertizë të specializuar dhe mbështetje: për të përgatitur informacionin e planifikuar në kohë dhe fushatat e komunikimit; mundëson përgjigje të shpejta dhe të sakta për të gjitha çështjet lidhur me veprimtarinë e ISSH të ngritura në mass-media; të drejtojë dhe mbështesë me këshilla të specializuara stafin në varësi për arritjen e detyrave.
3. Koordinimi: të bashkëpunojë me stafin për arritjen e rezultateve. Shqyrton korrespondencën dhe materialet e tjera që adresohen në sektor, merr masa dhe cakton detyrat për punonjesit për të zgjidhur problemet në kohë.
4. Planifikimin e Buxhetit: të propozojë shpenzimet për sektorin në brenda buxhetit të brendshëm të miratuar.

Prezantimi i Detyrave:

1. Promovon imazhin e institucionit: organizon ngjarjet që lidhen me institutin, përgatit logot dhe fjalimet. Përgatit ose redakton publikimet organizative për audiencat e brendshme dhe të jashtme, përfshirë, gazetën e punonjesve dhe raportet e të interesuarve. Mundëson dalje publike, leksione apo shfaqje për të rritur sensibilitetin ndaj shërbimeve dhe politikave të reja të ISSH dhe të sigurojë mirekuptimin e partnereve. Të studiojë objektivat, politikat promovuese dhe nevojat e organizatës për të zhvilluar strategji për marrëdhëniet me publikun për të arritur mbështetjen e opinionit publik për prodhimet dhe shërbimet e reja. Bashkëpunon me të gjithë menaxherët për të identifikuar drejtimet dhe grupet kyce të interesave dhe shqetësimet.
2. Zhvillon fushata informimi dhe komunikimi: Propozon mesazhet kryesore tek drejtori i përgjithshëm, përcakton kanalet e informacionit, identifikon burimet financiare, zhvillon

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

dhe shpërndan prodhimet. Vendos dhe mban lidhje bashkëpunuese me përfaqësuesit e komunitetit, konsumatorët, punonjesit dhe grupet publike të interesave.

3. Komunikon me mass-median, opinionin publik dhe vecanërisht me përfituesit: përgjigjet për kërkesat për informacion te rregullt për mass-median dhe krijon një zëdhënës të duhur apo burim informacioni; përgatit deklaratat për shtyp dhe kur hyjnë në fuqi ligjet dhe nënligjet e reja dhe për evenimente të tjera; dorëzon artikujt në gazetat lokale, lidhur me çështje të ndryshme. I gjithë komunikimi me mass median dorëzohet tek Drejtori i Përgjithshëm për miratim pasi është kontrolluar saktësia e çështjeve të diskutuara. Koordinon të gjitha veprimtaritë e nevojshme për hartimin e faqes së internetit të ISSH, mirëmbajtjen dhe azhornimin. Zhvillon mjetet e duhura te informacionit për të gjitha klasat e përfituesve duke përdorur mjetet e komunikimit në masë: TV, internet, gazeta, revista, reklama.
4. Organizon kuadrin e komunikimit të brendshëm; Promovon rregulloret e brendshme për organizimin e ISSH dhe funksionimin e saj; shpërndan mjete – intranet, qarkore, gazeta dhe procedura të komunikimit të brendshëm; përgatit konferencat e shtypit.

Arsimi dhe Eksperienca

Diplomë universitare në marrëdhëniet me publikun dhe komunikim, gazetari ose psikologji dhe të paktën 5 vjet eksperiencë pune në administrimin publik apo mass-media dhe marrëdhëniet me publikun.

Aftësitë

1. Komunikimi dhe Media: njohuri të prodhimeve të medias, komunikimin dhe shpërndarjen e teknikave dhe metodave. Kjo përfshin rrugët alternative për të informuar dhe mirekuptuar përmes medias së shkruar, gojore dhe vizuale.
2. Shërbimi i klientit: njohuri të parimeve dhe proceseve për ofrimin e shërbimeve të klientit. Kjo përfshin llogaritjen e nevojave të klientit, arritjen e standarteve të cilësisë për shërbimet dhe vlerësimin sa është plotësuar dëshira e klientit
3. Psikologji: njohuri për sjelljen dhe performancën njerëzore.
4. Shkrimi: komunikimi efektiv me shkrim sic duhet për nevojat e audiencës.
5. Mendimi kritik: përdorimi i logjikës dhe arsytimit për të identifikuar forcat dhe dobësitë e zgjidhjeve alternative, përfundimet apo përjasja ndaj problemeve.
6. Kuptimi i Leximit: të kuptojë fjalitë e shkruara dhe paragrafët në dokumentat lidhur me punën.
7. Dëgjimi aktiv: të japë vemendjen maksimale për atë cka po thonë njerëzit, duke kaluar kohë për të kuptuar pikat për të cilat u fol, duke bërë pyetjet me vend dhe duke mos ndërprerë në kohë të papërshtatshme.
8. Të folurit: të flasësh me të tjerët për të transmetuar informacionin efektivisht.

Specialist për marrëdhëniet dhe komunikimin me publikun

Detyra të përgjithshme: të mbështesë përgjegjesin e sektorit për të organizuar, zhvilluar dhe vlerësuar informacionin dhe fushatat e komunikimit me përfituesit, partnerët institucionale etj.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

Përgjegjësitë

1. Lidhet me përgjegjesin e sektorit lidhur me zhvillimin dhe implementimin e iniciativave të ISSH në fushën e skemës suplementare
2. Lidhet me të gjithë drejtorite e ISSH të të gjitha niveleve për të arritur objektivat.
3. Mundëson ekspertizën e specializuar në fushën e marrëdhënieve publike dhe komunikimit.

Prezantimi i detyrave:

1. Përgatit analizat dhe ben planifikimin e fushatave informative dhe komunikative
2. Identifikon dhe zhvillon të gjitha mjetet e nevojshme dhe burimet për implementimin e fushatave.
3. Merr pjesë në përcaktimin dhe shpërndarjen e procedurave dhe mjeteve për komunikimin e brendshëm.
4. Merr pjese në hartimin, mirëmbajtjen dhe azhornimin e faqes së internetit të ISSH.
5. Përgatit korrespondencën me drejtorite brenda dhe jashtë ISSH
6. Vendos marrëdhënie të bashkëpunimit me median, gazetarët dhe shoqërinë civile.
7. Mbledh të dhënat e nevojshme nga drejtorite dhe sektorët e ISSH, përgatit materialin e miratuar për konferencën e shtypit dhe ndjek procedurat për publikimin dhe shpërndarjen në destinacion.
8. Mbledh informacionin e nevojshëm, përpunon dhe përgatit njoftimet periodike për komunikim të jashtëm dhe të brendshëm.
9. Mbledh informacionin e nevojshëm, përgatit dhe shpërndan deklaratat për shtyp.
10. Mbështet veprimtaritë e sektorit në fushën e marrëdhënieve me publikun.
11. Merr pjesë në takime të ndryshme, seminare, trainime etj, kur i kërkohet apo rekomandohet nga drejtuesit

Arsimi dhe Eksperienca

Diplomë universitare në marrëdhëniet me publikun dhe komunikim, gazetari ose psikologji dhe të paktën 5 vjet eksperiencë pune në administrimin publik apo mass-media dhe marrëdhëniet me publikun.

Aftësitë

1. Komunikimi dhe Media: njohuri të prodhimeve të medias, komunikimit dhe shpërndarjes së teknikave dhe metodave. Kjo përfshin rrugët alternative për të informuar dhe komunikuar përmes medias së shkruar, gojore dhe vizuale.
2. Shërbimi i klientit: njohuri të parimeve dhe proceseve për ofrimin e shërbimeve të klientit. Kjo përfshin llogaritjen e nevojave të klientit, arritjen e standarteve të cilësisë për shërbimet dhe vlerësimi i plotësimit të dëshirave të klientit
3. Psikologji: njohuri të sjelljes njerëzore dhe performancës.
4. Shkrimi: komunikimi efektiv me shkrim sic duhet për nevojat e audiencës.
5. Mendimi kritik: përdorimi i logjikës dhe arsytimit për të identifikuar forcat dhe dobësitë e zgjidhjeve alternative, përfundimet apo përjasja ndaj problemeve.
6. Kuptimi i Leximit: të kuptojë fjalitë e shkruara dhe paragrafët në dokumentat lidhur me punën.
7. Dëgjimi aktiv: të japë vëmendjen maksimale për atë cka po thonë njerëzit, duke kaluar kohë për të kuptuar pikat për të cilat u fol, duke bërë pyetje me vend dhe duke mos ndërprerë në kohë të papërshtatshme.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

8. Të folurit: të flasë me të tjerët për të transmetuar informacionin efektivisht.

ORGANIZIMI I SEKTORIT TE STATISTIKES DHE AKTUARISTIKES

Pergjegjes i Sektorit

Detyra e Pergjithshme:

1. Pergjigjet per pergatitjen e statistikave dhe analizave aktuariale dhe parashikon planifikimin e buxhetit afashkurter dhe afatgjate, furnizon DP me raporte demografike sociale dhe ekonomike si dhe me analiza per dokumentimin e politikave dhe vendimeve kryesore.

Pergjegjesite:

1. Koordinim hierarkik: lidhet me drejtorin per percaktimin e nevojave kryesore per statistika dhe analiza aktuariale vjetore; i raporton Drejtorit te Pergjithshem per keto ceshtje.
2. siguron ekspertize te specializuar dhe mbeshtetje: dokumentim te vendimeve dhe politikave kryesore me analiza dhe studime; drejtim i stafit ne varesi per realizimin e detyrave.
3. Koordinimi: kooperon me stafin e DRSSH per arritjen e rezultateve me cilesi te larte; koordinon me institucionet qendrore per shkembimin e te dhenave, shqyrton korrespondencen dhe materialet e tjera qe i adresohen Sektorit, merr masa dhe cakton detyra per punonjesit per zgjidhjen e problemeve ne kohe.

Prezantimi i detyrave:

1. ben vleresime afashkurtra dhe afatgjata per aktuarin. Per kete aresye:
 - percakton parametrat, ben parashikime ekonomike dhe demografike dhe harton metoda per zhvillimin e ketyre vleresimeve
 - bashke me specialistin, perditeson ne menyre konstante modelin aktuarial ne perputhje me ndryshimet legjislative
 - propozon ndryshime ne legjislacion dhe ne rregulloret ne perputhje me keto vleresime
 - pergatit dhe publikon raporte periodike afatshkurtra aktuariale
 - Siguron mbledhjen e te dhenave nga brenda dhe jashte ISSH, te dhena qe do te sherbejne si te dhena hyrese dhe parashikime per modelet aktuariale
 - Llogarit efektet financiare per te gjitha programet e sigurimeve shoqerore, per ndryshimet e propozuara ne legjislacion dhe rregullore
 - Propozon zbatimin e ndryshimeve me efektive me kostot me optimale.
2. koordinon aplikimin e parashikimeve aktuariale afatshkurtra dhe afatgjata, analizon te dhenat dhe paraqet propozimet perkatese.
3. percakton listen e raporteve per publikim.
4. kooperon me organizma kombetare dhe nderkombetare per shperndarjen e raporteve.

Arsimi dhe Eksperienca:

Diplome Universitare ne matematike, ekonomik, shkenca shoqerore dhe statistika dhe te pakten 5 vjet eksperience ne fushen e administrimit publik dhe/ose ne nivele te larta

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

menaxhimi; ne rast te nje titulli "master", te pakten 3 vjet eksperience ne fushen e administrimit publik dhe/ose ne nivel te larte menaxhimi. Eksperienca ne kerkime shkencore dhe operacionale eshte e detyrueshme.

Aftesite:

1. Aftesi te mira organizative dhe zotesi per te identifikuar dhe perdorur burimet financiare dhe njerezore per arritjen e objektiveve.
2. Aftesi te zhvilluara nderpersonale per t'u marre me stafin e te gjitha niveleve te organizates.
3. Aftesi te shendosha ne vendimarrje dhe zotesi per te analizuar, shpjeguar dhe argumentuar vendime, per te pergatitur raporte;
4. Aftesi drejtuese te shendosha, aftesi per te vendosur nje kulture pune ne organizate si dhe per te formesuar qendrimit kryesore te stafit te ISSH-se.
5. Standarte te larta te sjelljes dhe vlerave personale, nje shembull per tu ndjekur nga te tjeret,
6. aftesi te mira per analizim te te dhenave dhe prognozot,
7. Njohuri te mira per sistemet e sigurimeve shoqerore ne nje perspektive krahasuese.
8. njohuri te mira per ta bere sistemin e sigurimeve shoqerore te qendrueshem.

Specialist statistike

Detyra e pergjithshme:

1. pergjigjet per koordinimin metodologjik te aktivitetit te statistikave: mbledhje te dhenash, perpunim te dhenash dhe analiza
2. pergjigjet per mirefunksionimin e skemes se te dhenave te pergjithshme, sakesine se tyre dhe respektimin e afatave per qarkullimin e informacionit.

Pergjegjesite:

1. Koordinim hierarkik: Lidhet me Pergjegjesin e Sektorit per pergatitjen dhe monitorimin e planit te statistikave, i raporton DP per kete ceshtje.
2. Pergatit mbledhjen e te dhenave dhe respekton procedurat dhe afatet.
3. Ndervepron me te gjitha drejtorite e ISSH-se ne te gjitha nivelet per te arritur synimet.
4. Jep mbeshtetje te plote per aktivitetet qe lidhen me planifikimin, organizimin dhe raportimin me shkrim.
5. Merr pjesë në trainime siç rekomandohet nga Përgjegjësi i Sektorit

Prezantimi i detyrave:

1. Pergatit mbledhjen e te dhenave, verifikon sakesine e te dhenave dhe pergatitit te gjithe statistikat ne formate te pranuar.
2. Pergatit statistika periodike per DP dhe drejtorite e ISSH ne te cilat duhet te bazohen vendimet e tyre.
3. Pergatit analiza me te shtjelluara kur kjo kerkohet.

Arsimi dhe eksperience:

Grade universitare ne matematike, ekonomik dhe shkenca sociale. Rekomandohet eksperience ne drejtim te bashkepunimit me institucione publike. Rekomandohet eksperience ne fushen e auditimit te institucioneve publike: procedura auditimi, praktika kontabilizimi.

Aftesite:

1. Kerkohen aftesi te mira nderpersonale. Ketu perfshihen: aftesi te mira per te degjuar te tjeret, per zgjidhjen e konflikteve, komunikimin ne grup dhe zotesine per t'u marre ne menyre efektive me menaxheret.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

2. Njohje të mire të legjislacionit dhe procedurave të sistemit të sigurimeve shoqerore.
3. Njohje të mire të menaxhimit dhe vleresimit të politikave publike.
4. Aftësi për të grumbulluar, analizuar dhe përpunuar të dhëna sasore dhe për të përgatitur raporte me shkrim.

Specialist aktuaristike

Detyrë e përgjithshme: të mbështesë përgjegjës të sektorit për përgatitjen dhe vlerësimin e planit buxhetit të ISSH me analiza aktuariale dhe parashikime

Përgjegjësitë:

1. bashkëvepron me përgjegjës në zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave të ISSH për analizat dhe parashikimet aktuariale, rekomandon përmirësim të politikave
2. ndervepron me drejtoritë e ISSH të të gjitha niveleve për arritjen e objektivave.
3. siguron ekspertizë të specializuar në fushën e kontabilitetit dhe mbështet aktivitetet e sektorit

Prezantimi i detyrave:

1. përgjigjet për zbatimin korrekt të modeleve aktuariale
2. administron modelet aktuariale afatshkurtra dhe afatgjata dhe përgjigjet për mirembajtjen e tyre
3. zbaton me korrektesë parashikimet përkatëse
4. bashkë me përgjegjës, përditeson vazhdimisht modelin aktuarial sipas ndryshimeve legjislative
5. poërgjigjet për raportimin e të dhënave të nevojshme, mbledhjen e tyre nga institucionet qendrore ose të tjera, aplikon modelet me të dhënat e fundit, përgatit raportet përfundimtare brenda afateve
6. bën sugjerime për rezultatet e studimeve dhe bën propozimet përkatëse
7. llogarit efektet financiare të të gjithë programeve të sigurimeve shoqerore për ndryshimet e propozuara në legjislacion dhe rregullore
8. bashkëpunon me statisticienët, sektorin buxhetor për marrjen e të dhënave lidhur me kushtet dhe progresin e treguesve statistikore dhe financiare
9. bashkëpunon me sektoret përkatëse në drejtorinë e përfitimeve për progresin e numrit të përfituesve, pensionin mesatar dhe të dhëna të tjera lidhur me to
10. bashkëpunon me drejtorinë e auditit për analizimin nëse perspektiva aktuariale është marrë në konsideratë nga ekipi i menaxhimit, me fokus të vecantë në ndikimin e politikave financiare dhe siguron ekspertizë në përmirësimin e detyrës, ky raport është pjesë e raportit vjetor të auditimit përgatitur nga Qeveria dhe Parlamenti
11. i përgjigjet përgjegjësit të sektorit për kryerjen e punës.

Arsimi dhe Eksperienca:

Diplome Universitare në matematikë, ekonomik, shkencë shoqerore, finance, kontabilitet dhe të paktën 5 vjet eksperience është e detyrueshme; Eksperienca në bashkëpunimin me institucione rekomandohet.

Aftësitë:

1. Kerkohen aftësi të mira nderpersonale. Ketu përfshihen: aftësi të mira për të degjuar të tjerët, për zgjidhjen e konflikteve, komunikimin në grup dhe zotesinë për t'u marrë në mënyrë efektive me menaxherët.
2. Njohje të mire të kompjuterit dhe të një gjuhe të huaj
3. njohje të mire, dhe specializim në studime aktuariale dhe për sistemet e sigurimeve shoqerore në perspektive krahasuese.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

Ne procesin automatik, statisticieni nuk do te kete me detyren per te mbledhur dhe ruajtur te dhenat; ai/ajo vetem do te permiresoje statistikat, do te analizoje keto te dhena dhe do te pergatise raporte.

Ne procesin manual, rekomandohet te ruhen te njejtat burime te mbledhjes se te dhenave dhe te perpunimit te te dhenave gjate procesit te raportimit, per te shmangur konfuzionet ne interpretim si dhe konkuzionet apo raportet e gabuara.

Ne periudhen e tranzicionit nga procesi manual ne automatik, duhet te ruhet i njehti specializim lidhur me detyrat e statisticieneve – shih me poshte. Per Qendren Pilot te Tiranes, procesi automatik nuk ben me te nevojshem mbledhjen dhe perpunimin manual te te dhenave. Puna e specialisteve do te kaloje drejt perditesimit te software-it ne perputhje me kerkesat e biznesit, permiresimit te statistikave dhe raporteve dhe analizave statistikore.

Specialist statistike per te dhenat financiare dhe te kontributeve

Specialist statistike per te dhenat per perfitimet

Specialiste te tjere

Detyra e pergjithshme: merr dhe pergatit te gjithe statistikat e nevojshme sipas afateve.

Pergjegjesite:

- a. Lidhet me Pergjegjesin e Sektorit per zbatimin e planit te statistikave.
- b. Pergatit mbledhjen e te dhenave dhe respekton procedurat dhe afatet.
- c. Ndervepron me te gjitha drejtorite e ISSH-se ne te gjitha nivelet per te arritur synimet.
- d. Jep mbeshtetje te plote per aktivitetet qe lidhen me planifikimin, organizimin dhe raportimin me shkrim.
- e. Merr pjesë në trainime siç rekomandohet nga Përgjegjësi i Sektorit

Prezantimi i detyrave:

1. Pergatit mbledhjen e te dhenave, verifikon saktesine e te dhenave dhe pergatitit te gjithe statistikat ne formate te pranuar.
2. Pergatit nje para-raport statistikor dhe nje analize permbledhese te te dhenave ne te.
3. Pergatit analiza me te shtjelluara kur kjo kerkoet.

Arsimi dhe eksperiencia:

Grade universitare ne matematike, ekonomik dhe shkenca sociale. Rekomandohet eksperience ne drejtim te bashkepunimit me institucione publike. Rekomandohet eksperience ne fushen e auditimit te institucioneve publike: procedura auditimi, praktika kontabilizimi.

Aftesite:

1. Kerkohen aftesi te mira nderpersonale. Ketu perfshihen: aftesi te mira per te degjuar te tjeret, per zgjidhjen e konflikteve, komunikimin ne grup dhe zotesine per t'u marre ne menyre efektive me menaxheret.
2. Njohje te mire te legjislacionit dhe procedurave te sistemit te sigurimeve shoqerore.
3. Njohje te mire te menaxhimit dhe vleresimit te politikave publike.
4. Aftesi per te grumbulluar, analizuar dhe perpunuar te dhena sasiore dhe per te pergatitur raporte me shkrim.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

ORGANIZIMI I SEKTORIT TE MENAXHIMIT TE RISKUT

Pergjegjes i Sektorit

3. Vlerëson dhe raporton tek Drejtori I Përgjithshëm mbi çështjet kyce në divizionin administrative bazuar në raportet vjetore që bëhen nga secili manaxher I DRSSH.

Detyrat

1. Krijon programe mujore dhe vjetore për Degën
2. Organizon studimet, propozimet dhe materialet e tjera të punës dhe I dorëzon ato tek Drejtori Rajonal
3. Manaxhon dhe drejton procesin e caktimit të punëmarrësve në secilin vend pune.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

4. Bën vlerësimin vjetor të punëmarrësve dhe propozon ndryshimet e vendeve të punës sipas aftësive të personelit dhe të legjislacionit në këtë fushë.
5. Krijon plane vjetore për trajnimin dhe identifikon ofruesit dhe kostot; dorëzon këtë program për aprovim nga Drejtori I Administrimit të Përgjithshëm në ISSH.
6. Krijon programe për përmirësimin e kushteve të punës dhe infrastrukturës
7. Krijon një plan për shpenzimet administrative, e dorëzon për miratim dhe monitoron shpenzimet.
8. Në bashkëpunim me departamentin e financës krijon project propozim të buxhetit të brëndshëm.

Arsimimi dhe Eksperienca

Diplomë Universitare në Ekonomi, Juridik, Administrim public dhe të paktën 10 vjet eksperiencë në fushëne administratës publike dhe/ose në nivel të lartë manaxhimi; Eksperienca në identifikimin dhe shpërndarjen e kurseve të trainimit do të ishte ndihmuese. Njohuri të parimeve manaxheriale, planifikimit strategjik, shpërndarjes së burimeve, modelimit të burimeve njerëzore, teknikave të lidërshiptit dhe koordinimit të njerëzve dhe burimeve do të ishte ndihmuese.

Aftësitë

1. Nevojiten afatësi të larta të brëndshme. Këto përfshijë aftësi dëgjimi, zgjidhje konfliktesh, komunikimi në grup dhe aftësi për tu marrë efektivisht me manaxherët.
2. Ndihmë për të vendosur dhe mirëmbajtur sistemet e duhura të vlerave ne fushën e administrimit.
3. Monitoron, vlerëson dhe raporton mbi ceshtjet e administrimit, planet dhe performancën e punës.

Kreu i Njësisë të Burimeve Njerëzore

Kreu i Njësisë

Detyra të përgjithshme:

1. Përgjegjës për manaxhimin e veprimtarive të Njësië lidhur me rekrutimin e stafit, përmirësimin e aftësive profesionale, vendosjes së trainimeve të duhura, vlerësimin të performancës së punës.
2. Të mbështesë Drejtorin e DRSSH në identifikimin e nevojave speciale të stafit dhe të marrë pjesë në zgjidhjen e konflikteve të punës.

Përgjegjësitë

1. Koordinimi Hierarkik: lidhje me Kreu e Divizionit për përmbushjen e planit të zhvillimit të burimeve njerëzore dhe raportimi për ceshtjet kyce të njësisë.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

2. Mundëson ekspertizë të specializuar dhe mbështetje: për rekrutimin e stafit, përgatitjen e përshkrimit të duhur të punës për secilin post pune sëbashku me drejtorin rajonal, vlerësimet vjetore dhe propozimet për promovime.
3. Koordinimi: të bashkëpunoj me stafin për arritjeve e rezultateve. Ekzaminon korrespondencën dhe aktet e tjera që I adresohen Sektorit, merr masa dhe cakton detyrat për punojësit për zgjidhjen e çështjeve në kohën e duhur.
4. Planifikimi I Buxhetit: Të propozojë shpenzimet për njësinë e tij brënda buxhetit të brëndshëm të aprovuar. Të propozojë zgjidhje për kontraktimin e ekspertizës së jashtme për trainimin e stafit.

Detyrat

1. përgatit rekrutimin e stafit në përputhje me procedurat ligjore dhe kriteret profesionale të përshkruara për secilin vend pune.
2. Organizon rekrutimin dhe përgatit raportin për zgjedhjen e stafit. Përmbyll kontratat e punësimit
3. Bashkëpunon me Drejtorin e Departamentit për propozimin e përshkrimit të punës për secilin staf të ri të rekrutuar për ALSSH apo DRSSH.
4. Vendos pagat dhe manaxhon dosjen e secilit punojës.
5. Monitoron performancën vjetore të punës së stafit dhe përgatit vlerësimin vjetor.

Arsimimi dhe Eksperiencia

Diplomë Universitare në ekonomik, juridik, administrim public, shkencë sociale, burimet njerëzore ose fushat lidhur me to, dhe të paktën 5 vjet eksperiencë në fushën e administrimit public.

Eksperiencia në identifikimin dhe shpërndarjen e kurseve të trainimit do të ishte ndihmuese. Njohuri të procedurave të rekrutimit, shpërndarjes së burimeve dhe zhvillimit të burimeve njerëzore është e rekomanduar.

Aftësitë

1. Nevojiten aftësi të larta të brëndshme. Këto përfshijë aftësi dëgjimi, zgjidhje konfliktesh, komunikimi në grup dhe aftësi për tu marrë efektivisht me manaxherët.
2. Ndihmë për të vendosur dhe mirëmbajtur sistemet e duhura të vlerave në fushën e administrimit.
3. Raproton aftësitë mbi zhvillimin e burimeve njerëzore dhe performancës së punës.

Specialisti i Burimeve Njerëzore

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

Detyra të përgjithshme: mbështet Kreun e njësisë për përgatitjen e të gjitha dokumentave të nevojshme për rekrutim, monitorimin dhe vlerësimin e stafit, zhvillimin e politikave të burimeve njerëzore.

Përgjegjësitë:

1. Lidhet me Kreun e Njësisë dhe performon të gjitha veprimtaritë e kërkuara
2. Vepron me Departamentet e tjera të ISSH në të gjitha nivelet për të arritur planet dhe qëllimet e njësisë.
3. Ofron mbështetje të plotë për planifikimin dhe organizimin e veprimtarive.

Detyrat:

1. përgatit dhe mban dokumentat e punojsëve sipas ligjeve në fuqi.
2. Azhornon dosjet e personelit
3. Klasifikon personelin sipas kriterëve të rregullores përkatëse.
4. Monitoron implementimin e rregulloreve të rekrutimit lidhur me personelin.
5. përgatit tabelën e pagave për punojësit
6. krijon dhe monitoron planin e lejeve vjetore
7. merr pjesë në procesin e vlerësimit të punojsëve dhe përgatit raportin përfundimtar.
8. krijon procedurat e punësimit sipas legjislacionit në fjalë.
9. në bashkëpunim me specialistin e statistikave përfundon të dhatat që kërkohen nga ISSH

Arsimimi dhe Eksperienca

Diplomë Universiteti në një nga vijueset: burimet njerëzore, ekonomik. Juridik, administrim public, shkencat sociale dhe politike.

Aftësitë

1. Njohje kompjuterike
2. aftësitë analitike
3. aftësitë komunikuese
4. një kuptim të qartë të manaxhimit të burimeve njerëzore
5. Aftësi të punojë me të dhëna dhe njerëz të të gjitha niveleve brënda organizatës.

Kreu I Njësisë së Administrimit të Përgjithshëm

Detyrat e përgjithshme: përgjegjës për organizimin e tenderave, monitorimin e procedurave publike, lidhja e kontratave, monitorimi i respektimit të kontratave.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

Përgjegjës për sigurimin e të gjitha burimeve materiale për infrastrukturën (rrjetet e komunikimit, shoferat, mjetet e konsumit) mirëmbajtje e ndërtesës dhe rehabilitimin.

Përgjegjësitë

1. Koordinimi Hierarkik: Lidhje me kreun e divizionit për përmbushjen e planit të prokurimeve publike dhe raportimi për ceshtjet kyce në njësi. Raprotimi mbi respektimin e termave të kontratës.
2. jep ekspertizë të specializuar dhe mbështetje për respektimin e procedurave të prokurimit public, organizimit të tenderave, sigurimin e vlerësimit transparent të ofertave, lidhja e kontratave.
3. Administrimi i Përgjithshëm: cakton nevojat dhe siguron furnizimin e materialeve dhe punësve
4. Planifikimi I Buxhetit: të propozojë shpenzimet për njësinë e tij brenda buxhetit të brendshëm të miratuar. Të raportojë mbi të gjitha shpenzimet e propozuara dhe të bëra gjatë vitit.

Detyrat

1. Vendos për planin vjetor të prokurimeve
2. vendos procedurat dhe mbikqyr për respektimin e tyre në transparencë të plotë.
3. Bën organizmin e tenderit publik.
4. Organizon tenderin dhe siguron se vlerësimi ka respektuar të gjitha termat e referencave.
5. përgatit kontratën me kompaninë fituese dhe e dorëzon për firmosje kontrate tek drejtori I divizionit dhe tek Drejtori I DRSSH
6. Mbyll kontratat për materialet dhe shërbimet e punëve për përmirësimin e infrastrukturës dhe për mirëmbajtjen e ndërtesës dhe për rehabilitim.
7. Monitoron respektimin e kontratave

Arsimimi dhe Eksperienca

Diplomë Universitare në juridik, inxhinieri apo fushat respective dhe të paktën 5 vjet eksperiencë në fushën e administrimit publik;

Eksperienca në prokurimet publike është ndihmuese.

Aftësitë

1. Nevojiten afatësi të larta të brëndshme. Këto përfshijë aftësi dëgjimi, zgjidhje konfliktesh, komunikimi në grup dhe aftësi për tu marrë efektivisht me manaxherët.
2. Ndihmë për të vendosur dhe mirëmbajtur sistemet e duhura të vlerave ne fushën e administrimit.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

Specialisti në Prokurimet Publike dhe Administrimin e Përgjithshëm

Detyra të përgjithshme: mbështet kreun e Njesisë për përgatitjen e të gjitha dokumentave të nevojshme për organizimin e tenderit, monitorimin e procedurave publike, lidhjen e kontratës, monitorimin e kontratës.

Përgjegjësitë:

1. Lidhet me Kreun e Njesisë në të gjitha veprimtaritë e njesisë lidhur me organizimin e tenderave, mbylljen e kontratave, shërbimeve të punës.
2. Ndërvepron me të gjitha departamentet e ISSH në të gjitha nivelet për të arritur qëllimet dhe planet e njesisë.
3. Ofron mbështetje të plotë për planifikimin dhe organizimin e veprimtarive.

Detyrat

1. Sipas legjislacionit në fuqi organizon të gjitha procedurat e tenderit dhe dorëzon rezultatin përfundimtar.
2. Sëbashku me juristin përgatit kontratat për kompanitë fituese.
3. Planifikon nevojat për pajsije për infrastrukturën, mirëmbajtje e ndërtesave dhe rehabilitim dhe i dorëzon ato tek drejtori rajonal

Arsimimi dhe Eksperienca

Diplomë universitare në ekonomik, juridik apo fushat respective dhe të paktën 3 vjet pë në fushën e administrimit publik; Eksperienca në prokurimet publike është ndihmuese.

Aftësitë

1. Nevojiten afatësi të larta të brëndshme. Këto përfshijë aftësi dëgjimi, zgjidhje konfliktesh, komunikimi në grup dhe aftësi për tu marrë efektivisht me manaxherët.
2. Njohuri të mira të legjislacionit të fushës

Specialisti për koordinimin e punës me Agjensitë

Ky post nuk justifikohet pasi këto detyra janë pjesë e detyrave manaxheriale të Drejtorit Rajonal që duhet të marrë vendimet në bashkëpunim me kabinetin bazuar në vlerësimet e tij dhe nga propozimet e bëra nga drejtorët e secilit department në DRSSH. Shih post për profiling e Drejtorit Rajonal.

Pritësit e Publikut dhe të administrimit të korrespondencës (i pandryshuar)

Teknicienët

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

Përshkrimi i punës për teknikienët e ndrsyhëm mbetet i pandryshuar: Specialisti për Investimet e Ndërtimit, Administratorii Ndërtesës, Operatori, Shoferët, centralisti, specialist për mirëmbajtje, kaldaisti, magazinieri, pastruesi, rojet.

Specialisti –administratorii rrjetit (pajisje/rrjet)

Detyra të përgjithshme: të mbështesë krijimin, konfigurimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e politikave të sigurimit të zyrave

Përgjegjësitë:

- lidhet me Kreun e sektorit në zhvillimin dh implementimin e iniciativave të ISSH
- krijon dhe konfigurion Rrjetet e ALSSH (LAN), Rrjetet e Gamës së Gjërë (ËAN) serverat, PC, Magazinimi masiv, Njësitë e Kasetave dhe periferikët e tjerë.
- Administrimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës në zyra
- Administrimi dhe mirëmbajtja e aplikimeve të ISSH
- Të trajnojë përdoruesit për të përdorur pajisjet.
- Të ndërveprojë me të interesuarit për të zgjidhur problemet e IT

Prezantimi i detyrave

- Të krijojë, konfigurojë, administrojë dhe irëmbajë politiakt e sigurisë së sistemit dhe infrastrukturën e zorave të caktuara.

Arsimi dhe Ekpserienca

Diplomë universitare në IT, inxhinieri dhe ose të pakën 2 vjet eksperiencë në Administrimin e Sistemeve.

Aftësitë

1. Aftësi të mira ndërpersonale. Kjo përfshin aftësi të mira dëgjimi, zgjidhje konfliktesh. Komunikimi në grup dhe aftësia për tu marrë fektivisht me manaxherët.
2. Të ndihmojë të vendosen dhe mbhen sistemet e duhura të vlerave në fushën e veprimeve të IT
3. Të monitorojë, vlerësojë dhe rapotojë në qështjet e sektorit të IT.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

ORGANIZIMI I DREJTORISË EKONOMIKE DHE FINANCIARE

- Drejtoria e Kontributeve
- Drejtoria e Financës

PERSHKRIMI I PUNES

DREJTOR EKONOMIK DHE I FINANCES

Detyra e pergjithshme:

1. pergjigjet para DP dhe KA per koordinimin e aktiviteve te drejtorive ne varesi te vet;
2. pergjigjet per mbikqyrjen e niveleve te kontrollit ne DRSSH – drejtorite e kontributeve;
3. koordinim i zhvillimit dhe zbatimit te politikave te qeverise, vleresim i rezultateve te projekteve ne fushen e perfitimeve te sigurimeve shoqerore;
4. ofron keshillim dhe pergatit raporte periodike per DP lidhur me fondet e ISSH te mbledhura nga personat fizik dhe juridike;
5. propozon modele/zgjidhje per qendrueshmerine financiare te skemes qe te mbaje nivele te larta te mbledhjes se kontributeve, per te perballuar koston e perfitimeve;
6. realizon marreveshje me institucione publike dhe private per menaxhimin e qarkullimit te parave per pagesen e perfitimeve (bankat e nivelit te dyte, posta qendrore, Ministria e Finances);
7. vlereson rezultatet e zbatimit te legjislacionit, ben te njohura rezultatet e projekteve tek stafi;
8. mbeshtet drejtorine e IT per zbatimin e SIMIS (perkufizim i kerkesave funksionale dhe analiza per legjislacionin, propozime per perditesim te programit sipaskerkesave te tij);

Pergjegjesite:

1. menaxhimi i projektit:
 - percakton objektive per cdo drejtori dhe kontrollon realizimin e tyre;
 - perfaqeson ISSH ne raport me partneret e ndryshem publike dhe private per prezantimin e politikave te ISSH dhe zgjidhjen e problemeve te ngritura nga partneret dhe institucionet publike per te bere te njohur objektivat e ISSH;
 - perfaqeson ISSH ne realizimin e marreveshjeve me institucionet private dhe publike ne fushen e tyre te kompetences;
 - kerkon nga cdo drejtori raporte periodike per shkallen e vleresimit te projekteve dhe te zbatimit te tyre;
 - ben rekomendime tek DP per zgjidhje te ndryshme per zbatimin e politikave, praktikat me te mira ne fushen perkatese, avantazhet dhe risqet e politikave te zgjedhura;
 - menaxhon marrjen dhe shperndarjen e korrespondences zyrtare dhe gjen pergjigje per cdo kerkese apo ankese ne bashkepunim me menaxheret ne varesi;

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

- vlereson cdo vit rezultatet ne cdo aspekt te aktivitetit, rekomandon zgjidhje per permiresim dhe perгатit parashikime per politika te reja;

2. menaxhimi i stafit:

- menaxhon stafin dhe raporton per progresin/ndryshimet/ evolucionin e performances se stafit
- analizon raportet e kontrolloreve dhe vlereson performancen e punes se tyre mujore, merr pjese ne kontrollet direkte te organizuara nga drejtoria e auditit ne DRSSH dhe ALSSH dhe asiston zgjidhjen e tyre;
- mbikqyr aplikimin e rregullores se brendshme per organizimin dhe funksionimin e drejtorise;
- perгатit pershkrimin e punes per Zyren Qendrore dhe DR – pozicionet e punes per menaxheret;
- perгатit vleresimin e stafit;
- mbeshtet Drejtorine e Administrimit te Pergjithshem ne perгатitjen e kritereve per rekrutim te stafit e ri.

3. planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit:

- propozon shpenzimet per drejtorine e vet brenda buxhetit te brendshem te aprovuar; siguron menaxhimin dhe kontabilitetin e buxhetit te brendshem;
- perгатit dhe monitoron planin e buxhetit vjetor te te ardhurave dhe shpenzimeve ne bashkepunim me Institutin e Sigurimit Shendetesor, Drejtorine e Pergjithshme te Taksave dhe Ministrine e Finances; perгатit raporte financiare dhe me te dhena, perгатit raporte periodike per kontabilitetin e buxhetit;
- perгатit planin mujor te buxhetit te brendshem te ISSH; aprovon dhe monitoron shpenzimet.

ORGANIZIMI I DREJTORISE SE FINANCES

Drejtor i Drejtorise

Spektori i Buxhetit (Njësia e Buxhetit të Përgjithshëm dhe Njësia e Buxhetit të Brendshëm)

Spektori i Thesarit

Spektori i Kontabilitetit

PERSHKRIMI I PUNES:

Drejtor:

Detyra te pergjithshme:

1. Pergjigjet per menaxhimin e pergjithshem te Drejtorise se Finances, ben plane dhe parashikime per menaxhimin e volumit te punes, stafit, burimeve te nevojshme, buxhetit dhe per aktivite te paplanifikuara.
2. Ekzekuton buxhetin e brëndshëm dhe të përgjithshëm
3. Ofron keshillim dhe ben raporte te rregullta per Drejtorin e Pergjithshem mbi fondet e ISSH-se.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

4. Monitoron zbatimin e planit financiar dhe aprovon te gjithë veprimet financiare per buxhetin e pergjithshem dhe te brendshem.
5. Propozon modele\zgjidhje per qendrueshmeri financiare te skemave per ruajtjen e nivelit te larte te mbledhjes se kontributeve per te mbuluar koston e perfitimeve.
6. merr pjese ne arritjen e marreveshjeve me institucione publike dhe private per menaxhimin e rrjedhes se parase (banka te nivelit te dyte, Ministria e Finances, Drejtoria e Pergjithshme e Taksave)
7. vlereson rezultatet e zbatimit te legjislacionit, perhapjen e rezultateve te projekteve tek stafi.
8. Mbeshtet Departamentin e Informatikes per zbatimin e SIMIS (perkufizim i kerkesave funksionale dhe analize te legjislacionit dhe propozon azhornimin e sistemit ne perputhje me te).

Pergjegjesite:

1. Menaxhim projekti:

- Te zhvilloje, zbatoje dhe monitoroje planin financiar te ISSH-se, perfshire planin e mbledhjes se kontributeve;
- Harton raporte te rregullt per informimin mbi fazen e ecurise dhe zbatimit te projekteve.
- Ben rekomandime per Drejtorin e Pergjithshem mbi zgjidhje te ndryshme per politikat – zbatimin, praktikat me te mira ne fushe, perpaesite dhe rreziqet e politikave te zgjedhura.

2. Menaxhimi i stafit:

- Te menaxhoje stafin dhe te raportoje mbi progresin\ndryshimet\ecurine e performances se stafit.
- merr pjese ne kontrollet direkte te organizuara nga Drejtoria e Auditit ne Drejtorine Rajonale dhe Agjensite Lokale dhe asiston ne zgjidhjen e tyre.
- Te supervizoje zbatimin e rregullores se brendshme per organizimin dhe funksionimin e departamentit;
- Te pergatise pershkrimet e punes per zyren qendrore, drejtorine rajonale dhe agjensite locale, vleresimin e stafit dhe rekomandime per ngritje ne detyre.
- Te mbeshtese Drejtorine e Administrimit te Pergjithshem ne pergatitjen e kriterave per rekrutimin e stafit te ri.

3. Planifikimi i buxhetit dhe menaxhimi:

5. Propozon shpenzime per departamentin brenda buxhetit te brendshem, mundeson menaxhimin dhe kontabilitetin e buxhetit te brendshem;
6. Pergatit dhe monitoron planin vjetor te buxhetit per te ardhurat dhe shpenzimet ne bashkepunim me Institutin e Sigurimeve Shoqerore, Drejtorine e Pergjithshme te Taksave; pergatit raporte financiare; pergatit rregullisht raporte mbi kontabilitetin e buxhetit.
7. Pergatit planin vjetor per buxhetin e brendshem te ISSH-se, aprovon dhe monitoron shpenzimet.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

Prezantimi i detyrave:

1. Planifikimi: ne bashkepunim me te gjithë sektoret ne zyrat qendrore te ISSH-se, harton projekt-buxhetin vjetor dhe parashikues, dhe programet e vecanta qe rrjedhin prej tij; koordinon analizen e politikave dhe vleresimeve per te dokumentuar te gjithë aktet ligjore dhe angazhimet financiare te parashikuara ne planin vjetor te Institucionit lidhur me buxhetin e pergjithshem dhe te brendshem te ISSH-se; pergatit vleresime financiare per te gjitha politikat e vendosura nga bordi i drejtoreve te ISSH-se; nxjerr raporte te rregullta (ditore, mujore dhe tre-mujore) mbi shifrat qe lidhen me qarkullimin ditor te parase, kontabilitetin e buxhetit, me perqendrim te vecante ne mbledhjen e kontributeve.
2. vendim-marrja: vlereson gjetjet dhe merr vendime ne kohen e duhur per te mundesuar vazhdimesine efektive te veprimtarise se departamenteve; delegon marrjen e vendimeve kur nevojitet; ne bashkepunim me Departamentin Ligjor inicion dhe pergatit ligjet dhe urdheresat, udhezimet dhe rregulloret per zbatimin e legjislacionit ekzistent; vendos dhe perditeson kerkesat funksionale per SIMIS ne perputhje me ndryshimet ne legjislacion, procedura dhe ne rrjedhen e punes.
3. Organizimi: perdor te gjithë burimet dhe fondet e disponueshme, perfshire stafin dhe ekspertizen e jashtme per te arritur qellimet e organizates; pergatit dokumentacionin perkates per mbledhjet e bordit dhe komitetit dhe ofron sherbime sekretariale per komitete te ndryshme sipas nevojës; rishikon dhe azhuron legjislacionin dhe procedurat ekzistuese te fushes dhe siguron pershtatjen me legjislacionin; propozon llojet, formatin dhe strukturen e dokumentave financiare dhe te kontabilitetit; perpunon udhezimet metodologjike per hartimin e planit te buxhetit per Sigurimet Shoqerore; percakton llojet e statistikave, formatin, perberjen dhe afatet per shkembimin e raporteve dhe te dhenave te perpunuara me institucionet e tjera. Organizon dhe koordinon aktivitetin financiar te Zyres Qendrore te ISSH-se dhe te gjithë njesive administrative: ndjek kontabilitetin, mbledh bilancet financiare tre-mujore dhe vjetore me shtojcat perkatese per Drejtorite Rajonale dhe ISSH-ne dhe pergatit bilancin financiar permbledhes te ISSH-se. Ne menyre periodike perpunon te dhenat operative per te ardhurat dhe shpenzimet e bera nga ISSH dhe mban kontakt me Thesarin e Buxhetit dhe Drejtorine e Kontabilitetit ne Ministrine e Finances. Ne menyre periodike perpunon te dhenat operative mbi implementimin e te ardhurave dhe shpenzimeve te ISSH-se dhe mban kontakt me Drejtorine e Ekonomise ne Ministrine e Punes dhe Ceshtjeve Sociale. Cdo muaj perpunon informacionin mbi zbatimin e buxhetit dhe kontrollin e shpenzimeve krahasuar me planin, rishikon treguesit e planit te buxhetit ne muajt Prill-Maj dhe Tetor-Nentor dhe propozon ndryshime ne fondet limit midis disa artikujve dhe shpenzimeve si dhe per t'i levizur nga nje njesi administrative ne tjeteren; ne raste te vecanta, sipas nevojave mund te behen nderhyrje mujore.
4. Koordinimi: koordinon aktivitetet e njesive nen vartesine e tij, Departamentin e Kontributeve dhe Sektorin e kontrollit Financiar; sinkronizon planet dhe aktivitetet me te gjithë departamentet ne ISSH dhe me institucione te tjera per te arritur qellimet e vena; bashkepunon me te gjithë departamentet dhe institucionet perkatese te perfshira; koordionon punen per zgjidhjen e problemeve midis nivelit qendror ne njeran ane dhe nivelit rajonal e agjensive locale; bashkepunon me Departamentin e Marredhenieve Publike per fushatat e informimit dhe komunikimit te zhvilluara nga ISSH; bashkepunon

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

me Zyren e Taksave per problemet qe lidhen me arritjen e te ardhurave te planifikuara dhe pagesen e kontributeve nga subjektet nen pergjegjesine e autoriteteve te Taksave. Asiston Drejtorine e Perfitimeve, Drejtorine e Kontributeve dhe Drejtorine Rajonale ne pergatitjen e buxheteve dhe planeve; ofron sherbime teknike dhe consultative per Drejtorine e Perfitimeve dhe Sektorin Juridik te ISSH-se.

5. Kontrolli: siguron qe sistemet e kontrollit te brendshem jane dokumentuar dhe fuqizuar, dhe masat per realizimin e tyre perdoren ne te gjithe organizaten; I propozon Drejtorit te Pergjithshem nje njoftim dhe ofron argumente per masa te marra disiplinore per punonjesit pergjegjes; zbaton sanksionet ne rastet e mos respektimit te rregullave te brendshme organizative ne pershtatje me Rregulloren e Brendshme. Supervizon zbatimin e akteve ligjore dhe proceduriale ne fushen e tij te aktivitetit ne secilin rajon dhe respektimin e afateve per zbatimin e detyrave, propozon per permiresime te nevojshme qe duhen bere, vlereson masat qe jane propozuar te merren. Per kete qellim, organizon kontrole tematike ne rajone dhe ne agjensite lokale qe perballen me problemet. Bashkepunon dhe i pergjigjet te gjitha kerkesave te Departamentit te Auditit per te pasur te drejte hyrje ne informacionin qe u nevojitet ne pershtatje me legjislacionin.

Arsimi dhe eksperiencia

Diplomë universitare në ekonomik dhe të paktën 10 vjet eksperiencë në fushën e administrimit publik dhe ose në nivel të lartë menaxhimi dhe në menaxhimin e burimeve njerëzore; në rast të një diplome "master", të paktën 7 vjet ekspseriencë në fushën e administrimit publik ose në nivel menaxhimi të lartë. Eksperiencia në bashkëpunimin me institucionet publike dhe private është e detyrueshme. Eksperiencia në menaxhimin financiar është e detyrueshme.

Aftësitë

1. Aftësi të mira organizative dhe aftësi për të identifikuar dhe përdorur burimet njerëzore dhe financiare për të arritur objektivat.
2. Aftësi ndërpersonale zhvilluara dhe aftësi për t'u marrë me stafin e të gjitha niveleve në institucion
3. Aftësi të shëndosha në vendim-marrje dhe një aftësi për të shpjeguar dhe mbështetur vendimet
4. Aftësi të mira drejtuese, aftësi për të vendosur kulturën e punës në organizatë si dhe për të formësuar qëndrimet kyçe të stafit të ISSH
5. Standarte të larta të sjelljes dhe vlerave personale, shembull për stafin që e ndjek.
6. Janë të detyrueshme njohuritë e mira të skemave të sigurimeve shoqërore në një perspektivë krahasuese
7. Janë të detyrueshme njohuritë e mira të legjislacionit përkatës (të fushës)
8. Eshtë e detyrueshme njohja e mirë e qëndrueshmërisë financiare të skemave të sigurimeve shoqërore

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

9. Njohuri të mira të sistemit kontabël dhe të organizmit të sistemit financiar të sigurimeve shoqërore në Shqipëri.

Sektori i Buxhetit

Buxheti i Brëndshëm Buxheti I Përgjithshëm

Rekomandohet të kemi një sektor ekonomik brënda Sektorit të Buxhetit për të siguruar ekzekutimin e dy detyrave të lidhura.

- Monitorimi e mbledhjes së të ardhurave, raporte periodike
- Llogaritja e buxhetit vjetor, planifikimi dhe rregullimi I buxhetit

Kreu i sektorit

Detyra të përgjithshme:

- përgjegjës për përpunimin e planit të buxhetit të përgjithshëm, sipas indikatorëve ekonomik
- monitorimi I të ardhurave nga mbledhja e kontributeve
- përgjegjës për përpunimin dhe ekzekutimin e planit të buxhetit të brëndshëm, sipas nevojave të shprehura nga drejtoritë qendrore dhe rajonale.

Përgjegjësitë:

- Koordinimi hirarkik: lidhet me drejtorine financës për planifikim, monitorim dhe vlerësim e buxhetit të përgjithshëm; raporton mbi mbledhjen e të ardhurave.
- Mundëson ekspertizë të specializuar dhe mbështetje; përgatit raportet për të nënvizuar pikat e forta dhe të dobëta të sistemit të mbledhjes së kontributeve; drejtimin e stafit nën vartësi për arritjen e detyrave
- Koordinimi: bashkëpunon me stafin e DRSSH dhe ALSSH për mbledhjen e raporteve ekonomike; koordinon me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe INSTAT për shkëmbimin e të dhënave.

Prezantimi I të dhënave:

- Në bashkëpunim me sektorët e tjerë të drejtorisë së kontributeve, sektorin e buxhetit, sektorin e aktuaristikës etj, përgatit planin vjetor të të ardhurave nga kontributet dhe prognozatat shumë vjeçare (përgjithësisht tre vjeçare)
- Organizon dhe koordinon veprimtaritë për mbledhjen e të dhënave nga DRSSH brënda afateve kohore dhe planifikon evidencat operative bazuar në formatet e miratuar për realizimin e të ardhurave
- Përgatit raporte të rregullta ekonomike për mbledhjen e kontributeve bazuar në të dhënat e mbledhura nga DRSSH.
- Ndjek cdo tremujor realizimin e të ardhurave nga kontributet në krahasim me planin vjetor.
- Organizon dhe koordinon shkëmbimin e të dhënave me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe nënvizon problemet për të cialt informon bordet drejtuese.
- Përgatit plan buxhetin e brëndshëm dhe koordinon veprimtaritë për implementim.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

Arsimi dhe Eksperienca

Diplomë universitare në ekonomik, kontabilitet, financë dhe të paktën 5 vjet punë në administratën publike dhe ose në nivel të lartë manaxhimi; ne rast të një masteri të paktën 3 vjet eksperiencë pune në administratën publike dhe/ose në nivel të lartë manaxhimi. Është e detyrueshme eksperienca në bashkëpunim me institutet publike.

Aftësitë

- Aftësi të mira organizative dhe aftësi për të identifikuar dhe përdorur burimet njerëzore dhe financiare për të arritur objektivat.
- Aftësi ndërpersonale zhvilluara dhe aftësi për t'u marrë me stafin e të gjitha niveleve në institucion
- Aftësi të shëndosha në vendim-marrje dhe një aftësi për të shpjeguar dhe mbështetur vendimet
- Aftësi të mira drejtuese, aftësi për të vendosur kulturën e punës në organizatë si dhe për të formësuar qëndrimet kyçe të stafit të ISSH
- Standarte të larta të sjelljes dhe vlerave personale, shembull për stafin që e ndjek.
- Njohri të mira të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave kuantitative
- Njohuri të mira të raportimit dhe analizimit të të dhënave

Njësia e Buxhetit të përgjithshëm

Specialist për monitorimin e të ardhurave nga kontributet

Detyra të përgjithshme: të mbështetëse përgjegjës e sektorit të zhvillojë, monitorojë dhe vlerësojë planin e të ardhurave.

Përgjegjësitë:

1. Vepron së bashku me përgjegjës të sektorit në zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave të ISSH-s në fushën e planifikimit të të ardhurave dhe monitorimin.
2. Bashkevepron me të gjitha departamentet e ISSH-s në të gjitha nivelet për të arritur qëllimet.
3. Jep ekspertizë të specializuar në fushën e planifikimit të të ardhurave dhe monitoron dhe mbështet aktivitetet e sektorit.

Prezantimi i detyrave :

1. Përgatit analizime dhe studime në mënyrë që të mbështeten të gjitha iniciativat e marra në terren.
2. Përgatit raporte mujore dhe tremujore për mbledhjen e kontributeve për të gjitha skemat dhe ia paraqet këto Drejtorit Ekonomik dhe të Financës.
3. Konfronton raportet ekonomike me statistikat dhe bën rekomandimet në lidhje me planet për mbledhjen e kontributeve për të rritur mbulimin e skemës kontributive.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

4. Përgatit korrespondencën me departamentet brenda dhe jashtë ISSH-s.

Arsimi dhe eksperiencia:

Diploma universitare në ekonomik, juridik ose administrim publik, matematikë etj dhe të paktën 2 vjet eksperiencë pune është e detyrueshme. Eksperiencë në bashkëpunimin me institucionet publike është e rekomandueshme.

Aftësitë:

1. Aftësi të mira ndërpersonale janë të nevojshme. Kjo përfshin aftësi të mira degjuese, zgjidhje konfliktesh, komunikimi në grup dhe aftësi për t'u përballur me manaxheret në mënyrë efektive.
2. Aftësi në kompjuter dhe njohuri në të paktën një gjuhë të huaj.

Njesia e Buxhetit të Brendshëm

Kreu i Njësisë

Detyra të përgjithshme: përgjegjës për planifikimin, ekzekutimin dhe kontabilitetin e buxhetit të brendshëm.

Përgjegjësitë:

1. Koordinimi Hierarkik: Lidhet me drejtorin për planifikimin, administrimin dhe kontabilitetin e planit të buxhetit të brendshëm të ISSH, mbikqyrjen e lëvizjes së parave dhe miratimin e tyre, raporton tek drejtori, dhe mbikqyrësit e tjerë sipas hierarkisë dhe tek Drejtori i Përgjithshëm mbi çështje kryesore të Sektorit.
2. Mundëson ekspertizën e specializuar dhe mbështetje: në planifikimin dhe përgatitjen e buxhetit të brendshëm; drejtimin e stafit sipas varësisë për arritjen e detyrave, administrimin dhe vlerësimin e planeve të miratuara financiare.
3. Koordinimi: bashkëpunon me të gjithë stafin e DRSSH dhe ALSSH për administrimin e buxhetit. Ndjek korrespondencën dhe aktet e tjera që adresohen tek sektori, merr masa dhe cakton detyra për punojësit e degëve për të zgjidhur çështjet në kohë.

Prezantimi i Detyrave

1. Organizon ndjekjen sistematike të shpenzimeve administrative, përpunon konkluzionet dhe informon në kohë Drejtorinë e Financave, etj.
2. Bashkëpunon me Drejtorinë e Auditit për kontrollet e përbashkëta mbi shpenzimet e bëra brenda administrimit të buxhetit të brendshëm në DRSSH.
3. Ndjek hartimin dhe përgatit analizat për bilancin financiar të ISSH
4. Ndjek përmbushjen e evidencës financiare brenda afateve të përcaktuara, zhvillon analizat dhe përgatit konkluzionet e analizave duke përcaktuar edhe masat përkatëse.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

5. Është përgjegjës për të mbajtur në rregull kontabilitetin analitik dhe sintetik të ISSH, përgatit bilancin, përpunon të dhënat dhe i vendos ato në librat kontabël së bashku me anekset respektive vetëm për llogaritë kryesore.
6. Ndjek hapjen e fondeve të caktuara bazuar në planet tre mujore dhe vjetore për shpenzimet administrative.
7. Mban dokumentacionin për të gjitha shpenzimet administrative të ISSH.
8. Kontrollon situatën e rasteve duke aplikuar dispozitat financiare për transfertën e mjeteve financiare.
9. Hap sistematikisht dokumentat financiarë në regjistrat përkatës dhe bën veprimet kontabël.
10. Koordinon punën me sektorin e buxhetit të përgjithshëm për të dhënë dhe përdorur sic duhet fondet e ISSH.

Arsimi dhe Eksperienca

Diplomë Universitare financë ose në kontabilitet, dhe të paktën 5 vjet punë është e detyrueshme. Eksperienca në bashkëpunimin me institutet publike është e rekomanduar.

Aftësitë:

1. Aftësi të mira ndërpersonale. Këto përfshijnë aftësi për të dëgjuar, zgjidhje konfliktesh, komunikimi në grup dhe aftësia për t'u marrë efektivisht me manaxherët.
2. Aftësi kompjuterike dhe njohuri të mira të sistemit të kontabilitetit në Shqipëri.
3. Njohuri të mira të sistemit të sigurimeve shoqërore të Shqipërisë.
4. Njohuri të mira të legjislacionit në këtë fushë.

Kryekontabilist

Detyra të përgjithshme: të mbështesë drejtuesin e sektorit për të përpunuar kontabilitetin e buxhetit të brendshëm

Përgjegjësitë:

1. Lidhet me përgjegjesin e sektorit për të kryer të gjitha aktivitetet për sigurimin e kontabilitetit të buxhetit të brendshëm.
2. Ndërvepron me të gjitha drejtoritë e ISSH të të gjitha niveleve për të arritur qëllimet.
3. Mundëson ekspertizë të specializuar në fushën e kontabilitetit dhe mbështet veprimtaritë e sektorit.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

Prezantimi i Detyrave

1. Mban kontabilitetin analitik dhe sintetik të ISSH për dokumentacionin lidhur me lëvizjen bankare, të arkës, magazinave dhe të kartave të llogarive analitike lidhur me këto.
2. mban dokumentacionin për shpenzimet administrative të ISSH.
3. Hap sistematikisht dokumentat financiar në regjistrat përkatës dhe bën kontabilitetin.
4. Mban kontakt me bankat për lëvizjen e parave.
5. Përpunon raporte financiare dhe statistike për lëvizjen e parave të instituteve dhe bën kontrollin përkatës për ligjshmërinë e pagesës.
6. Bashkëpunon me shefin e sektorit për të përgatitur plan buxhetin dhe bilancet financiare periodike dhe vjetore.
7. përgatit llogaritjet analitike për kontributet e paguara për secilin nëpunës dhe bën të mundur vendosjen e tyre në llogaritë përkatëse.
8. Është përgjegjës për përfundimin e raporteve brenda afateve kohore.

Arsimi dhe Eksperienca

Diplomë Universitare në ekonomi, financë ose kontabilitet dhe të paktën 5 vjet punë është e detyrueshme. Rekomandohet eksperience në bashkëpunimin me institucionet publike.

Aftësitë:

1. Aftësi të mira ndërpersonale. Këto përfshijnë aftësi për të dëgjuar, zgjidhje konfliktesh, komunikimi në grup dhe aftësia për t'u marrë efektivisht me menaxherët.
2. Aftësi kompjuterike dhe njohuri të mira të sistemit të kontabilitetit në Shqipëri.
3. Njohuri të mira të sistemit të sigurimeve shoqërore të Shqipërisë.
4. Njohuri të mira të legjislacionit në këtë fushë.

Llogaritar/arkëtar

Detyrat e përgjithshme: të mbështesë përgjegjësia e sektorit për të monitoruar dhe regjistruar të gjitha transaksionet dhe veprimet me para.

Përgjegjësitë:

1. Lidhet me drejtuesin e sektorit për të siguruar kryerjen e të gjitha transaksioneve dhe veprimeve me para.
2. Ndërvepron me drejtorinë e ISSH të të gjitha niveleve për të arritur qëllimet.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

3. Mundëson ekspertizë të specializuar në fushën e kontabilitetit dhe mbështet veprimtaritë e sektorit.

Prezantimi i detyrave

1. Përgatit mandatpagesa për cdo transaksion dhe shpenzim të ISSH
2. Hedh të gjitha të dhënat në librin financiar
3. Bën një bilanc ditor të arkës
4. sigurohet të paguajë pagat në datat e caktuara
5. tërheq para nga banka
6. reflekton të gjitha hyrjet dhe daljet e artikujve në librat analitikë të magazinës.
7. Bën transaksionet në monedha të tjera për ISSH dhe hedh të dhënat në një libër të veçantë.
8. Ndan honoraret për Këshillin Administrativ dhe këshilltarët e jashtëm të ISSH.
9. Bën një bilanc mujor të arkës dhe të kontrollit të magazinës dhe bilanc të arkës cdo tre muaj.
10. Bashkëpunon me llogaritarin për problemet që kanë të bëjnë me ligjshmërinë e shpenzimeve.
11. Merr pjesë në përmbushjen e planit të shërbimit dhe të furnizimit me palët e treta.
12. Përgjigjet tek shefi i sektorit për arritjen e punës funksionale.
13. Është përgjegjës për veprimet e parregullta që janë kundra ligjit në sektorin pages dhe nuk bën asnjë transaksion pa udhëzimet ekzakte.

Arsimi dhe Eksperienca

Diplomë Universitare në kontabilitet dhe të paktën 5 vjet punë është e detyrueshme. Eksperienca në bashkëpunimin me institutet publike është e rekomanduar.

Aftësitë:

1. Aftësi të mira ndërpersonale. Këto përfshijnë aftësi për të dëgjuar, zgjidhje konfliktesh, komunikimi në grup dhe aftësia për t'u marrë efektivisht me menaxherët.
2. Aftësi kompjuterike dhe njohuri të mira të sistemit të kontabilitetit në Shqipëri.
3. Njohuri të mira të sistemit të sigurimeve shoqërore të Shqipërisë.
4. Njohuri të mira të legjislacionit në këtë fushë.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

SEKTORI I THESARIT

Përgjegjës i Sektorit

Detyra të përgjithshme: përgjegjës për menaxhimin e lëvizjes ditore të parave, investimit dhe kontabilitetin e Fondit Rezervë, koordinimin e punës për të mbajtur likuiditetet e mjaftueshme në llogaritë e ALSSH dhe për të optimizuar rentabilitetin e fondeve të ISSH;

Përgjegjësitë

1. Koordinimi Hierarkik: lidhet me Drejtorin për optimizimin e menaxhimit financiar afat-shkurtër; të raportojë tek Drejtori dhe mbikqyrësit e tjerë të hierarkisë dhe tek Drejtori i Përgjithshëm mbi çështjet kyç të Sektorit.
2. Mundëson ekspertizë të specializuar dhe mbështetje: Implementimi I procedruave administrative për manaxhimin e rrjedhës ditore të parave dhe investimin e fondit rezervë.
3. Koordinimi: të koordinojë me stafin e ISSH dhe në nivel rajonal për të urdhëruar transferimin e fondeve në llogaritë e agjensive locale. Ekzaminon korrespondencën dhe akte të tjera që janë adresuar njësisë, merr masat dhe cakton detyrat për nënpunësit për të zgjidhur problemet në kohë.

Prezantimi i Detyrave

1. Monitoron hyrjet dhe daljet nga Llogaria e Unifikuar e ISSH – bashkëpunon me Bankën Kombëtare të Shqipërisë (Llogaria e Unifikuar e Thesarit) dhe Ministrinë e Financës
2. Përgatit raportet ditore mbi mbledhjen e të ardhurave për secilën skemë të sigurimeve shoqërore dhe shpenzimet përkatëse.
3. Analizon dhe përgjigjet për investimet e fondeve, qarkullimin monetar, financimin përmes fondeve të buxhetit.
4. Menaxhon lëvizjen ditore të parave në përputhje me Planin e Thesarit miratuar nga Drejtori i Financës për të mbajtur një thesar të centralizuar (fonde të pashpërndara në llogaritë e ALSSH në bankat e nivelit të dytë), urdhëron transfertat dhe mbikqyr investimet për të vepruar në interesin më të mirë të institutit
5. Përgatit raporte për ekzekutimin e të ardhurave në bashkëpunim me drejtuesin e shërbimit financiar të DRSSH, merr masa për të paguar interesat bankarë, komisionet etj.
6. Bazuar në plain vjetor të miratuar dhe analizat e lëvizjes së likuideve, siguron likuiditetet e nevojshme për secilën ALSSH dhe monitoron shpenzimet. Urdhëron transfertat dhe financimin ditor të transfertave dhe mbledh deklaratet mujore të bankave.
7. Merr masa për përgatitjen e dokumentacionit financiar për pagesën e përfitimeve dhe për përmirësimet e mundshme në rast të shpenzimeve të reja. Kontrollon procedurat e pagesës së aplikuar, dhe raportet e bëra nga DRSSH mbi pagesën e përfitimeve.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

Arsimi dhe Eksperienca

Diplomë universitare në financë, kontabilitet, ekonomik dhe të paktën 5 vjet ekspseriencë në administrimin publik dhe ose në nivel të lartë menaxhimi; në rast të një diplome master, të paktën 3 vjet ekspseriencë në fushën e administrimit publik dhe ose në nivel të lartë menaxhimi. Eksperienca në manaxhimin financiar është e detyrueshme.

Aftësitë

1. Aftësi të mira organizative dhe aftësi për të identifikuar dhe përdorur burimet njerëzore dhe financiare për të arritur objektivat.
2. Aftësi ndërpersonale të zhvilluara dhe aftësi për t'u marrë me stafin e të gjitha niveleve të institucionit
3. Aftësi të mira në vendim-marrje dhe një aftësi për të shpjeguar dhe mbështetur vendimet
4. Aftësi të mira drejtuese dhe aftësi për të vendosur kulturën e punës të organizatës dhe të vendosë qëndrimet kyç të stafit të ISSH
5. Standarte të larta të sjelljes dhe vlerave personale, një shembull për t'u ndjekur nga stafi.
6. Njohuri të mira të sistemit të kontabilitetit dhe organizimit në sistemin financiar të sigurimeve shoqërore në Shqipëri.

Specialistë

Detyra të përgjithshme: përgjegjës për të marrë kërkesat ditore për para nga llogaritë e ALSSH dhe përgatitjen e transfertave të likuiditeteve.

Përgjegjësitë

1. Lidhet me Përgjegjesin e Sektorit për analizën e kërkesave të agjensive lokale të ISSH dhe përgatitjen e transfertave
2. Ndërvepron me të gjitha drejtoritë e ISSH të të gjitha niveleve për të arritur qëllimet.
3. Mundëson ekspertizë të specializuar në fushën e kontabilitetit dhe mbështet veprimtaritë e sektorit.

Detyrat

1. Merr kërkesat ditore për likuiditetet e nevojshme nga ALSSH dhe verifikon likuiditetet ekzistuese në llogaritë e tyre.
2. Përgatit transfertën për secilën agjensi në përputhje me kërkesat dhe mundësinë e fondeve dhe dorëzon propozimin tek drejtuesi i sektorit

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

3. Regjistron çdo transaksion të bërë gjatë ditës në përputhje me standartet dhe kodet kontabël.

4. Merr dhe regjistron raportet ditore financiare të marra nga bankat e nivelit të dytë, Banka Kombëtare dhe Ministria e Financës.

Arsimi dhe eksperiencia:

Diplomë universitare në financë ose kontabilitet dhe të paktën 5 vjet punë është e detyrueshme. Rekomandohet eksperiencë në institucionet publike.

Aftësitë:

1. Aftësi të mira ndërpersonale. Këto përfshijnë aftësi për të dëgjuar, zgjidhje konfliktesh, komunikim në grup dhe aftësi për t'u marrë efektivisht me menaxherët.

2. Aftësi kompjuterike dhe njohuri të mira të sistemit të kontabilitetit në Shqipëri.

3. Njohuri të mira të sistemit të sigurimeve shoqërore të Shqipërisë.

4. Njohuri të mira të legjislacionit në këtë fushë.

Specialist për qarkullimin monetar dhe investimet e fondeve

Detyra të përgjithshme: të mbështesë Përgjegjesin e Sektorit për të organizuar, monitoruar dhe vlerësuar qarkullimin monetar dhe investimin e fondeve në ISSH

Përgjegjësitë:

1. Lidhet me drejtuesin e sektorit në zhvillimin dhe implementimin e iniciativave të ISSH për qarkullimin monetar dhe investimin e fondeve..

2. Ndërvepron me drejtoritë e ISSH të të gjitha niveleve për të arritur qëllimet.

3. Mundëson ekspertizë të specializuar në fushën e kontabilitetit dhe mbështet veprimtaritë e sektorit.

Prezantimi i detyrave

1. Përgatit planin mujor/vjetor të financimit për buxhetin dhe e paraqet atë tek drejtuesi i sektorit.

2. Ndjek tërheqjet periodike, duke siguruar dokumentacionin përkatës për aplikimin e tyre.

3. Është përgjegjës për aplikimin e procedurave të buxhetit lidhur me qarkullimin monetar, investimin e fondeve dhe lidhje me buxhetin

4. Koordinon punën me specialistët e Drejtorisë së Thesarit në Ministrinë e Financës lidhur me tërheqjen e fondeve dhe subvencioneve, përmbush plan projektin operativ të lëvizjes së arkës (case traffic) dhe përgatit dokumentacionin për transferimin e financimeve dhe subvencioneve nga zyra qendrore tek DRSSH.

RREGULLORE E BRENDSHME E ISSH-së

5. Ndjek financimin e DRSSH dhe ALSSH me qëllimin për të krijuar një rezervë të limituar të nevojshme për pagesën e pensioneve në bashkëpunim me DRSSH merr masa për progresin normal të procesit të pagesës financiare.
6. Në librin korrespondues për fondin rezervë, shënon dhe reflekton situatën e fondit rezervë sipas degëve të sigurimeve.
7. Përgatit periodikisht, së bashku me kontabilistin e buxhetit, bilancin për ndarjen e të ardhurave dhe përdorimin sipas degëve duke reflektuar në detaje mbi balancën e të ardhurave.
8. Reflekton të ardhurat nga fondi rezervë, të ardhurat nga investimet, të ardhurat nga interesat, kamatvonesat, etj, si përcaktohet në ligj.
9. Është përgjegjës për investimin e fondit rezervë, pjesës konstante dhe mjeteve të lira përkohësisht, gjithmonë duke patur parasysh aplikimin e dispozitave, kufijve dhe shkallën e riskut.
10. Në bashkëpunim me kontabilistin e sektorit të buxhetit parallogarit mjetet e lira të përkohshme, ndjek kushtin e tyre dhe përcakton modalitetet e investimit. Pas aprovimit të Drejtorit të Financës dhe Drejtorit të Përgjithshëm merr masa për investimin e tyre.
11. Ndjek rezultatet e të ardhurave nga interesat e fondeve të investuara dhe së bashku me kontabilistin e kontabilitetit siguron se ato janë kontabiluar korrektësisht.
12. Merr masa për ndjekjen operative të fondeve të parave në bankat e nivelit të dytë dhe mbledh fondet e lira në një llogari të veçantë për t'i përgatitur për investim.
13. Merr pjesë në përpilimin e buxhetit dhe ndjek aplikimin e tij.

Arsimi dhe eksperiencia:

Diplomë universitare në kontabilitet ose në financë dhe të paktën 5 vjet punë është e detyrueshme. Rekomandohet eksperiencë në institucionet publike.

Aftësitë:

1. Aftësi të mira ndërpersonale. Këto përfshijnë: aftësi për të dëgjuar, zgjidhje konfliktesh, komunikim në grup dhe aftësi për t'u marrë efektivisht me menaxherët.
